



VLERËSIM I PROCESIT TË KTHIMIT VULLNETAR NË KOSOVË

TETOR 2014



Organization for Security and
Co-operation in Europe
OSCE Mission in Kosovo

Mohim përgjegjësie:

Versioni i këtij publikimi në gjuhën angleze është versioni zyrtar. Gjitha versionet e këtij publikimi në gjuhët tjera janë përkthim nga versioni origjinal në anglisht, si dhe nuk janë dokumente zyrtare.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
2. HISTORIK	6
3. ZBATIMI I KORNIZËS LIGJORE DHE TË POLITIKAVE.....	8
3.1 <i>Pasqyrë e kornizës ligjore dhe të politikave në Kosovë që ka të bëjë me personat e zhvendosur.....</i>	8
3.1.1 <i>Korniza ligjore</i>	8
3.1.2 <i>Dokumentet e politikave</i>	9
3.2 <i>Rishikimi i zbatimit të veprimeve në mbështetje të kthimit të qëndrueshëm</i>	11
3.2.1 <i>Zyrat komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK)</i>	11
3.2.2 <i>Grupet punuese komunale për kthim (GPKK)</i>	12
3.2.3 <i>Task forcat komunale për kthim</i>	13
3.2.4 <i>Strategjitë komunale për kthimin</i>	13
3.2.5 <i>Funksionimi i përgjithshëm i mekanizmave komunalë.....</i>	14
3.2.6 <i>Ministria dhe mekanizmat në nivel qendror.....</i>	14
4. ÇËSHTJET PRONËSORE	15
5. ÇËSHTJET E SIGURISË.....	18
5.1 <i>Siguria për të kthyerit dhe në vendet e kthimit</i>	18
5.2 <i>Reagimet e institucioneve të Kosovës ndaj incidenteve të sigurisë</i>	19
6. SHQETËSIMET QË KANË TË BËJNË ME KOMUNITETET PRANUESE	20
6.1 <i>Kundërshtimi i komunitetit pranues ndaj kthimeve</i>	20
6.2 <i>Reagimet komunale ndaj kundërshtimit të komuniteteve pritëse ndaj kthimit</i>	21
7. ASPEKTET RAJONALE	22
7.1 <i>Fushat kryesore të prekura nga bashkëpunimi rajonal</i>	22
7.2 <i>Gjendja aktuale në kuptimin e bashkëpunimit rajonal</i>	23
8. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	24
<i>Rekomandimet.....</i>	25
SHTOJCA I TABELA 1: TABELA E FUNKSIONEVE TË NDËRMARRA NGA ZKKK-TË, NGA KOMUNA	28
SHTOJCA II TABELA 2: MEKANIZMAT KOMUNALË TË KRIJUAR DHE FUNKSIONALË, SIPAS KOMUNAVE	32

LISTË E SHKURTESAVE

KQSH	Komisioni Qendror Shqyrtues
PZH	Personat e zhvendosur
KDR	Këshilli Danez për Refugjatë
VSHI	Vizitat shko dhe informohu
VSHSH	Vizitat shko dhe shih
BE	Bashkimi Evropian
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
ON	Organizata Ndërkombëtare
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
ZKK	Zyra Komunale për Komunitete
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZKK	Zyrtari Komunal për Kthim
GKPK	Grupi Komunal i Punës për Kthim
ZÇK	Zyra për Çështje të Komuniteteve
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë
AKP	Agjencia Kosovare për Privatizim
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
KRK	Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë
UNHCR	Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në përputhje me mandatin e saj thelbësor promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) vazhdon ta mbështesë procesin e kthimit në Kosovë, t'i monitorojë trendët dhe ta vlerësojë përputhshmërinë institucionale me kornizën e zbatueshme ligjore dhe të politikave. Ky raport ofron një pasqyrë të gjendjes aktuale të kthimit vullnetar në Kosovë, duke përfshirë zhvendosjen e personave të prekur nga konflikti në vendet fqinje dhe brenda vetë Kosovës. Raporti mbulon periudhën nga korriku i vitit 2012 deri në shtator të vitit 2014 dhe paraqet informata të përditësuara të raportit të OSBE-së për kthimin vullnetar të publikuar në vitin 2012.

Që nga viti 2012, institucionet e Kosovës kanë shënuar progres në trajtimin e nevojave të popullatës së prekur, gjegjësisht përmes zhvillimit të dokumenteve kyçe të politikave lidhur me kthimin. Pavarësisht këtij zhvillimi pozitiv, raporti vë në pah pengesat dhe progresin e kufizuar në fusha kyçe që kanë ndikim negativ tek personat e zhvendosur, qofshin këta brenda Kosovës ose dhe jashtë saj, si dhe aftësinë e tyre për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme.

Ende ka zbrazëtira në legjislacionin primar, duke përfshirë mungesën e dispozitave specifike që kanë të bëjnë me personat e zhvendosur dhe personat e kthyer. Shumë nga mekanizmat e nivelit lokal nuk janë themeluar si duhet ose nuk janë funksionalë dhe ndonëse zyrtarët komunalë për komunitete dhe kthim janë aktivë dhe ofrojnë një mbështetje më të madhe në disa fusha, ky veprim priret të lidhet me programe të kthimit të financuar nga donatorët. Në nivelin qendror, pavarësisht disa përmirësimeve në menaxhimin e informacionit që nga viti 2012, pranimi dhe procedimi i kërkesave vazhdon të jetë problematik. Progres i kufizuar është vërejtur në mbrojtjen dhe promovimin e pronës dhe të drejtave banesore të personave të zhvendosur dhe të kthyer, duke përfshirë vonesa në zgjidhjen e kërkesave pronësore që kanë të bëjnë me konfliktin dhe dështimet në zbatimin e vendimeve, probleme lidhur me detyrimet e tatimit pronësor të personave të zhvendosur, mangësi në procesin e shpronësimit dhe alternativa të pakta për të kthyerit që nuk kanë tokë në pronësi.

Çështjet e sigurisë vazhdojnë të kenë ndikim si në perceptimin e sigurisë ashtu edhe në procesin e kthimit. Një numër i konsiderueshëm i incidenteve janë regjistruar çdo muaj, dhe ndonëse shumë prej tyre janë relativisht incidente të vogla, janë shënuar edhe incidente më të rënda, duke përfshirë zjarrvënien dhe dëmtimin e vendeve të trashëgimisë fetare. Një numër i vogël i vendeve të kthimit përjetojnë incidente të përsëritura dhe tensione të vazhdueshme ndërmjet komunitetit pritës dhe atij që kthehet. Në disa zona, komunitetet pritëse janë faktor shtesë në parandalimin e progresit, dhe në këtë drejtim janë regjistruar shtatë peticione të paraqitura kundër kthimeve të propozuara gjatë dy viteve të fundit. Reagimet e komunave ndaj incidenteve të sigurisë dhe peticioneve kanë ndihmuar shumë në disa raste, por duhet të ndërmerren hapa shtesë, duke përfshirë nga Policia e Kosovës (PK), si organi me përgjegjësinë kryesore për siguri. Në fund, ndonëse ka pasur progres pozitiv kohëve të fundit në drejtim të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve relevante të rajonit të Ballkanit Perëndimor në çështjen e zhvendosjes nga Kosova, është e nevojshme të ndërmerren veprime të mëtutjeshme nga këta aktorë në shkëmbimin e informatave, njohjen e dokumenteve zyrtare dhe aktivitete të përbashkëta të kontaktimit me personat e zhvendosur.

OSBE bën thirrje për veprime më të mira nga institucionet relevante të Kosovës për ndërmarrjen e të gjitha masave legislative dhe praktike në mënyrë që të sigurohet progres në zotimet e Kosovës për kthimin. OSBE bën thirrje për bashkëpunim të shtuar institucional ndërmjet administratave të nivelit qendror dhe lokal, veprim më të mirë nga ministrinë relevante të Kosovës, Agjencia Kosovare e Pronës, gjykatat dhe PK, dhe që komunat t'i japin sa më parë përparësi ndarjes së tokës dhe shfrytëzimit të mundësisë së banimeve sociale në mbështetje të kthimit. Gjithashtu, OSBE bën thirrje që të ndërmerren hapa të mëtutjeshëm nga PK dhe udhëheqësia komunale për t'i trajtuar incidentet e sigurisë, duke e pasur parasysh ndjeshmërinë e veçantë të rasteve që lidhen me kthimin. Në fund, raporti thekson nevojën për bashkëpunim më të mirë ndërmjet institucioneve në Kosovë dhe autoriteteve fqinje ku aktualisht gjenden persona të zhvendosur nga Kosova.

1. HYRJE

OSBE-ja rregullisht monitoron gjendjen lidhur me personat e zhvendosur dhe kthimin, si dhe publikon raporte të rregullta për këto çështje, së fundmi më 2012.¹ Qëllimi i raportit është që të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes aktuale të kthimit vullnetar të personave të zhvendosur nga Kosova gjatë konfliktit të 1998-1999 dhe trazirave të marsit 2004. Përmes shqyrtimit të çështjeve kryesore që ndikojnë në aftësinë e këtyre personave për qasje në zgjidhje të qëndrueshme, qoftë përmes kthimit në Kosovë qoftë përmes integritimit të tyre në vendin e zhvendosur, raporti mëton t'i nënvizojë pengesat e mbetura dhe të paraqes rekomandime për aktorët relevantë në përkrahje të kthimit dhe riintegritimit të personave të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës.

Raporti fillimisht paraqet një pasqyrë të shkurtër të situatës, në kapitullin vijues të historikut, pasuar nga pjesa që shqyrton kornizën ligjore dhe të politikave të Kosovës dhe zbatimin e saj. Vijon një pjesë tematike që paraqet informacione për çështje kyçe që ndikojnë në kthimet e identifikuar gjatë monitorimit të rregullt të OSBE-së, gjegjësisht, çështje pronësore që prekin personat e zhvendosur, siguria dhe perceptimi i sigurisë, çështje që kanë të bëjnë me komunitetet pranuese dhe me të kthyerit e mundshëm në lokacione specifike, si dhe bashkëpunimi rajonal për çështjen e të zhvendosurve nga Kosova. Pjesa e fundit paraqet konkludimet dhe rekomandimet për politika për aktorët dhe vendimmarrësit kryesorë.

Raporti bazohet në informatat e mbledhura nga OSBE-ja nga shtatori 2012 deri në gusht të vitit 2014, plotësuar me të dhëna për personat e zhvendosur të siguruara nga Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) dhe Ministria e Kosovës për Komunitete dhe Kthim (MKK). Ekipet e OSBE-së në terren kanë mbledhur informacione në nivel lokal lidhur me performancën e komunave që përfshijnë analizën e të dhënave sasiore për zyrat përkatëse komunale, vlerësimin e cilësisë të funksioneve të caktuara lidhur me kthimin dhe riintegritimin, si dhe shqyrtimin e dokumenteve kryesore komunale. Ngjashëm, Ekipet e OSBE-së në terren kanë mbledhur të dhëna sasiore për incidente të sigurisë që kanë prekur personat e kthyer dhe perceptimin e sigurisë të komuniteteve dhe kanë shqyrtuar incidentet e rënda dhe lokacionet ku janë regjistruar këto probleme që kanë të bëjnë me komunitetet pritëse. OSBE-ja gjithashtu ka përdorur raportet e rregullta monitoruese të ekipeve të saj në terren për t'i theksuar brengat e identifikuar lidhur me të drejtat pronësore dhe banesore që prekin kthimin e personave të zhvendosur. Konsultimet dhe intervistat me përfaqësues të institucioneve qendrore dhe aktorë relevantë ndërkombëtarë (duke përfshirë UNHCR dhe Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM)), në kombinim me shqyrtimin e raporteve relevante nga OSBE-ja dhe aktorëve të tjerë ndërkombëtarë janë përdorur për t'i plotësuar informatat e mbledhura në nivel terreni dhe për të mbështetur shqyrtimin e kornizës ligjore dhe të politikave dhe perspektivën rajonale për zhvendosjen.

2. HISTORIK

E drejta e personave të zhvendosur për t'u kthyer në shtëpitë e tyre në mënyrë të sigurt dhe me dinjitet, si dhe për ta rikthyer pronën dhe pasurinë e tyre (apo për të marrë kompensim adekuat) është e mishëruar në standardet dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e

¹ Raporti i OSBE-së *Vlerësim i procesit të kthimit vullnetar në Kosovë*, tetor 2012. <http://www.osce.org/kosovo/96805> (qasur më 30 shtator 2014).

njeriut që janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë.² Këto të drejta janë të lidhura ngushtë me tri të drejta themelore të njeriut: lirinë e lëvizjes, gëzimin e lirshëm të pasurisë dhe pronës, si dhe respektimin e jetës private dhe familjare.³ Institucionet e kanë për obligim që t'i krijojnë kushtet dhe sigurojnë mjetet e nevojshme për t'ua bërë të mundur personave të zhvendosur kthimin në shtëpitë e tyre në mënyrë të sigurt dhe me dinjitet, të marrin pjesë plotësisht në planifikimin dhe menaxhimin e kthimit dhe riintegrimin të tyre, si dhe të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në çështjet publike dhe të kenë qasje të barabartë në shërbime publike.⁴

Vlerësimet e UNHCR-së të vitit 2012, përlllogarisin që 220,000 persona nga Kosova vazhdojnë të jenë të zhvendosur si rezultat i konfliktit të viteve 1998–1999 në Kosovë dhe trazirave të marsit 2004, kryesisht në Serbi (210,146), Mal të Zi (8,560) dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (1,100).⁵ Procesi i kthimit vullnetar i personave të zhvendosur (PZH) po vijon me ritëm të ulët, me vetëm 25,430 PZH të kthyer vullnetarisht në Kosovë deri në korrik të vitit 2014 dhe me rënie të numrit të të kthyerve për çdo vit⁶. Të dhënat e UNHCR-së që nga korriku i vitit 2014, regjistrojnë 192 të kthyer vullnetarë në Kosovë gjatë këtij viti nga Serbia qendrore, Mali i Zi, dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, ku shumica e të cilëve janë nga komuniteti serb, vijuar nga egjiptianët, ashkallitë dhe një numër shumë i vogël i komuniteteve të tjera të Kosovës.⁷ Mesatarja e të kthyerve gjatë viteve 2012, 2013 dhe 2014 deri më sot tregon një përfaqësim gati plotësisht të barabartë gjinor me 49.78 për qind gra në mesin e të kthyerve⁸.

Përveç personave të zhvendosur jashtë Kosovës, UNHCR vlerëson se 17,227 persona të tjerë vazhdojnë të jenë zhvendosur brenda Kosovës⁹, shumica prej të cilëve në pjesën veriore të Kosovës dhe në komunën e Graçanicës.¹⁰ Në Kosovë kanë mbetur tridhjetegjashtë qendra

² Shih nenin 13.2 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; nenin 12.4 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; dhe nenin 5.d.ii i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor; këto zotime janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në Kosovë (neni 22 i Kushtetutës së Kosovës). Veç këtyre, relevante janë edhe: Parimet Udhëzuese për Zhvendosjet e Brendshme (E/CN.4/1998/53/Add.2), 11 shkurt 1998; Parimet për Banimin dhe Rikthimin e Pronës për Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur (E/CN.4/Sub.2/2005/17), 11 gusht 2005 (“Parimet e Pinheiro-s”); Njëzet Udhëzimet e Këshillit të Evropës (KE) për Kthimin me Forcë, shtator 2005 (Udhëzimet e KE”).

³ Shih Protokollin 4, neni 2; Protokollin 1, neni 1; dhe neni 8, respektivisht. Këshilli i Evropës, *Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, ndryshuar me Protokollet nr. 11 dhe 14*, 4 nëntor, ETS 5, në dispozicion në: <http://www.refworld.org/docid/3ae6b3b04.html> (qasur më 8 tetor 2014).

⁴ Këshilli Ekonomik dhe Social, E/CN.4/Sub.2/2005/17, 28 qershor 2005, Shtojca.

⁵ ‘Përlllogaritje e refugjatëve dhe personave të zhvendosur ende në ndjekje të një zgjidhjeje në Evropën Juglindore’, UNHCR shtator 2012.

⁶ Për shembull, gjatë tre viteve të fundit numrat janë ulur si vijon: 2,318 në 2010; 1,192 në 2011; 1,043 në 2012; dhe 809 në 2013 dhe 234 nga janari deri në korrik 2014, Pasqyrë e Përgjithshme Statistike e UNHCR, shtator 2014. Profilizimi i kryer nga UNHCR në vitin 2011 në bashkëpunim me komisariatit e Serbisë për refugjatët dhe JIPs gjeti se 97,000 persona të zhvendosur janë ende në nevojë për një zgjidhje të qëndrueshme.

⁷ Shumica e të kthyerve vullnetarë deri më tani në vitin 2014 janë kthyer nga Serbia qendrore, kryesisht në rajonin e Gjilanit/Gnjilane (56) dhe Prizrenit (36), ndërkohë që të kthyerit nga Mali i Zi janë kthyer vetëm në Pejë/Peć (15), ata nga IRJM kryesisht në Prishtinë/Priština (23), dhe brenda Kosovës në Gjilan/Gnjilane (19) Prishtinë/Priština (130) dhe Mitrovicë/Mitrovica (13). Numri më i madh i të kthyerve vullnetarë në vitin 2014 ishin serbë të Kosovës (105) që ktheheshin nga Serbia qendrore në Kosovë, si dhe një numër më i vogël i serbëve të Kosovës që janë kthyer në vendet e tyre nga vendi ku kanë qenë të zhvendosur brenda Kosovës. Komuniteti i dytë për nga numri i kthimit janë egjiptianët e Kosovës dhe ashkallitë e Kosovës (të regjistruar si grup i përbashkët në analizën statistikore të UNHCR, 74) që janë kthyer nga Mali i Zi, IRJM dhe Serbia qendrore, të pasuar nga goranët e Kosovës (11) dhe boshnjakët e Kosovës (9), të kthyer në Kosovë nga Serbia qendrore. UNHCR, *po aty*, shënim 6.

⁸ UNHCR, *më sipër*, shënim 6.

⁹ UNHCR, *më sipër*, shënim 6.

¹⁰ Shifrat e UNHCR tregojnë se 6,945 serbë të Kosovës të zhvendosur nga Mitrovica e jugut aktualisht janë vendosur në katër komunat veriore të Zvečan/Zveçanit, Zubin Potok/Zubin Potokut, Leposavić/Leposaviqit dhe Mitrovicës/Mitrovica veriore, dhe se 7,121 shqiptarë të Kosovës të zhvendosur nga këto komuna veriore janë aktualisht në Mitrovicë/Mitrovica jugore. Në vende të tjera në Kosovë dhe në numër më të vogël, PZH-të serbë të Kosovës gjithashtu

kolektive¹¹ dhe të dhënat e UNCHR tregojnë që këto qendra strehojnë 643 individë, shumica prej të cilëve janë serbë (540 individë) të vendosur në Shtërpçë dhe në katër komunitete veriore¹². Banorët e tjerë të qendrave kolektive, shqiptarët, romët, ashkallitë dhe egjiptianët e Kosovës, persona të zhvendosur brenda Kosovës, janë kryesisht të vendosur në Mitrovicën jugore dhe Mitrovicën veriore.¹³ Është shënuar përparim i konsiderueshëm gjatë vitit 2012 dhe 2013 në kampet e përkohshme kolektive të prekura nga ndotja me plumb dhe tani janë të gjitha të mbyllura.¹⁴ Më 2014, MKK-ja u zotua se do t'i mbyllë qendrat e tjera kolektive; megjithatë, ndonëse janë ndërmarrë disa hapa, deri më tani veprimet e mëtejshme mbesin kryesisht në fazën e planifikimit dhe çfarëdo përparimi i bërë është i ndikuar nga çështje të pazgjidhura pronësore.¹⁵

Fonde të konsiderueshme – deri në 16 milionë euro për vitet 2012, 2013 dhe 2014 – janë ndarë për zbatimin e projekteve për kthim në Kosovë nga donatorë ndërkombëtarë, dhe disa kanë qenë të bashkëfinancuara edhe nga MKK-ja. Këto projekte kanë për qëllim mbylljen e kampeve të PZH-ve në Kosovën veriore¹⁶, stabilizimin e komunitetit¹⁷ dhe kthimin dhe riintegrimin e personave të zhvendosur në Kosovë duke përfshirë ndërtimin e shtëpive dhe rindërtimin, shpërndarjen e pakove emergjente dhe riintegrimin e qëndrueshëm.¹⁸

3. ZBATIMI I KORNIZËS LIGJORE DHE TË POLITIKAVE

3.1 Pasqyrë e kornizës ligjore dhe të politikave në Kosovë që ka të bëjë me personat e zhvendosur

3.1.1 Korniza ligjore

Korniza ligjore në Kosovë riafirmon të drejtën në kthim në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe përvijon garanci gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të komuniteteve. Kushtetuta shprehimisht përcakton se institucionet e

banojnë në Gračanica/Graçanicë dhe fshatrat përreth (1,217), dhe në Štrpce/Shtërpçë dhe komuna të tjera të rajonit të Gjilanit/Gnjilane (1,144). Një numër shumë i vogël i komuniteteve të tjera janë të prekura nga zhvendosja brenda Kosovës, duke përfshirë këtu komunitetin rom të Kosovës, ashkali të Kosovës dhe egjiptian të Kosovës, aktualisht të zhvendosur kryesisht në rajonin e Prishtinës/Priština dhe atë të Pejës/Peć. Të dhënat e UNCHR të paraqitura në takimin e Task Forcës për Zgjidhje të Qëndrueshme, 4 shtator 2014, Prishtinë/Priština.

¹¹ Ndonëse nuk ka përkufizim formal të “qendrave kolektive”, ato janë ndërtesa dhe objekte që kanë ekzistuar më parë dhe që janë shfrytëzuar si vendbanime kolektive dhe të përbashkëta për personat e zhvendosur në rast të ndonjë konflikti ose katastrofe natyrore, shih Udhëzuesin e UNHCR-së dhe IOM-it për Qendrat Kolektive, 2010 <http://www.globalccmccluster.org/system/files/publications/doc18990-contenido.pdf> (qasur më 24 tetor 2014).

¹² Zvečan/Zvečan, Zubin Potok, Leposavić/Leposaviq dhe Mitrovica/Mitrovicë të veriut.

¹³ Të dhënat e UNHCR i vërtetojnë 254 familje si të zhvendosura aktualisht në qendrat kolektive në rajonin e Mitrovica/Mitrovicës veriore, nga të cilat 225 në Mitrovica/Mitrovicën veriore dhe 29 në Mitrovicën/Mitrovica jugore. UNHCR *po aty*, fushnota 6.

¹⁴ Qendra e përkohshme kolektive e fundit në Leposavić/Leposaviq për familjet rome, ashkali dhe rome të Kosovës u mbyll në dhjetor të vitit 2013, sidoqoftë ende duhet gjetur zgjidhje të qëndrueshme për katër familjet që akoma jetojnë në vendin ku ndodhet kampi. Shumica e personave të zhvendosur u rivendosën në Mitrovicë/Mitrovica jugore, ku testet e fundit për nivelin e plumbit në gjak kanë treguar se nuk ka më raste me nivele shqetësuese mbi 45mg/dl.

¹⁵ Një faktor kyç që ndikon në mbylljen e disa qendrave kolektive është zgjidhja në pritje e çështjeve pronësore apo të banimit të disa banorëve. Disa banorë nuk kanë gëzuar pronësi apo çfarëdo të drejte tjetër banesore të njohur me ligj para zhvendosjes, ose nuk i kanë dokumentet pronësore që dëshmojnë të drejtat e tyre banesore që i kanë gëzuar më herët. Të tjerët po presin që lëndët e tyre të vendosen nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP), ose si në shumë raste banorët e qendrave kolektive, titujt pronësor të së cilëve u janë vërtetuar nga AKP-ja, ende kanë problemeve në qasjen në pronat e tyre për shkak të uzurpimit të paligjshëm e të vazhdueshëm.

¹⁶ BE-MRSI, mbyllja e kampeve në Çesmin Lug dhe Osterod, shkurt 2010- dhjetor 2012; BE-Mercy Corps, kthimi dhe riintegrimi i komuniteteve pakicë, 2013-2014 (komponenti I).

¹⁷ BE-IOM, faza II e projektit të stabilizimit të komuniteteve, 2012-2013.

¹⁸ BE-IOM, kthimi dhe riintegrimi në Kosovë, faza III (RRK III); BE-UNHCR, kthimi dhe riintegrimi i komuniteteve pakicë, 2013-2014 (komponenti II).

Kosovës “promovon dhe lehtëson kthimin e sigurt dhe me dinjitet të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, dhe u ndihmon atyre për kthimin e pronave dhe posedimeve të tyre”.¹⁹ Protokollin për kthimin vullnetar dhe të qëndrueshëm i vitit 2006 vërtetoi detyrimet e të gjitha palëve për të siguruar kthim të sigurt dhe të papenguar të personave të zhvendosur në vendet e tyre të prejardhjes, rivendosjen e të drejtave të tyre pronësore si dhe krijimin e kushteve për lëvizjen e lirë e të gjithë personave.²⁰ Në vitin 2010 institucionet e Kosovës miratuan Rregulloren për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (Rregullorja për ZKKK)²¹ që përcakton themelimin e mekanizmave lokalë të bashkërendimit për kthimin dhe çështjet e komuniteteve në të gjitha komunat dhe që përbën legjislacionin më të hollësishëm që ka të bëjë me kthimin në nivel lokal.²² Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve²³ nuk përban ndonjë dispozitë të veçantë për PZH dhe të kthyerit, por sidoqoftë mishëron disa të drejta themelore të rëndësishme për të siguruar riintegrim të plotë të të kthyerve dhe PZH-ve.²⁴ Përkundër këtyre zotimeve, ende nuk ka legjislacion të hollësishëm që në mënyrë të veçantë ka të bëjë me kthimin dhe riintegrimin. Me qëllim të trajtimit të mungesës së një kornize të detajuar ligjore, në vitin 2014, MKK ndërmoi hapa për hartimin e një instrumenti²⁵ për personat e zhvendosur brenda Kosovës përmes themelimit të një grupi punues në mars të vitit 2014 për këtë qëllim. Grupi punues erdhi në përfundim se profilizimi i personave të zhvendosur brenda Kosovës, është parakusht për të përcaktuar se cila do të jetë politika apo instrumenti ligjor më i përshtatshëm për t'i trajtuar çështjet që kanë të bëjnë me zhvendosjen në Kosovë. Në bashkëpunim me UNHCR dhe Këshillin Danez për Refugjatë (DRC), MKK-ja ka filluar procesin e profilizimit të personave të zhvendosur brenda Kosovës (duke përfshirë edhe të dhënat në bazë të gjinisë) dhe kryerjen e një analizë ligjore, dy hapa që do të siguronin vlerësim faktik dhe ligjor të nevojave me qëllim të hartimit të instrumentit. Sidoqoftë, MKK ende nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për ta rishikuar kornizën ligjore për kthimin dhe riintegrimin e që tani drejtohet vetëm nga dokumentet e politikave (shih pjesën 3.1.2).

3.1.2 Dokumentet e politikave

Janë tri dokumente kyçe të politikave: Doracaku i rishikuar për kthim të qëndrueshëm (2006)²⁶ (doracaku), Udhëzuesi për zbatimin e përkrahjes për kthim (2012)²⁷ (udhëzuesi) dhe

¹⁹ Shih nenet 22 dhe 156 të Kushtetutës së Kosovës, 15 qershor 2008.

²⁰ “Protokollin për kthim vullnetar dhe kthim të qëndrueshëm mes Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovës (IPVQ) dhe Qeverisë së Serbisë”, 6 qershor 2006. http://www.brookings.edu/~media/Projects/idp/Serbia_ReturnProtocol_2006.PDF (qasur më 15 shtator 2014).

²¹ Zyra e Kryeministrit, Rregullorja nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, miratuar më 12 gusht 2010; në dispozicion në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullore_per_Zyrat_komunale_per_Komunitete_dhe_Kthim.pdf (qasur më 15 shtator 2014).

²² Për një analizë të kësaj rregulloreje, shih raportin e OSBE-së (2012), fusnota 1 më sipër, f. 8–11.

²³ Ligji nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Kosovë, 13 mars 2008.

²⁴ Këto përfshijnë dispozitat për sigurinë, pjesëmarrjen publike, arsimin, mundësitë sociale dhe ekonomike dhe gjuhën. Nenet 1, 2, 4, 8, 9, 11, fusnota 23 më sipër.

²⁵ “Instrumenti” është çfarëdo dokumenti ligjor apo i politikave që trajton problemin e personave të zhvendosur sipas standardeve ndërkombëtare.

²⁶ Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë/Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovës (IPVQ), *Doracaku i ripunuar për kthim të qëndrueshëm*, korrik 2006. Korniza e politikave e miratuar në vitin 2006 është e mbështetur në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përfshirë Parimet Udhëzuese të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi Zhvendosjen e Brendshme të vitit 1998.

²⁷ MKK, Udhëzimet për zbatimin e përkrahjes për kthim, 27 mars 2012. <http://www.mkk-ks.org/repository/docs/Guidelines%20for%20Implementation%20of%20Return%20Support2.pdf> (qasur më 15 shtator 2014).

Strategjia për komunitete dhe kthim (2014–2018 dhe Plani i veprimit)²⁸ (strategjia dhe plani i veprimit).

Që nga viti 2006 dokumenti kyç i politikave për kthimin vullnetar ka qenë doracaku, me anë të të cilit përkufizohen rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të nivelit qendror dhe atij lokal në çdo fazë të procesit të kthimit dhe i cili përvijon procedurat dhe mekanizmat e bashkërendimit për trajtimin e nevojave dhe promovimin e të drejtave të PZH-ve dhe të kthyerve.²⁹ Udhëzuesi dhe strategjia dhe plani i veprimit të miratuara më pas janë kryesisht në përputhje me procedurat dhe mekanizmat e themeluar sipas doracakut për mbështetjen e kthimit dhe riintegrimin të personave të zhvendosur.

Në mars të vitit 2012, MKK botoi udhëzuesit e shumëpritur të saj që përcaktonin mekanizmat e standardizuar të miratimit (përzgjedhjen e përfituesve dhe procedurat e vënies në prioritet), si dhe që përkufizonin, për çdo fazë të procesit të kthimit, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të përfshira. Udhëzuesi thekson se procesi i kthimit është angazhim i përbashkët i të gjithë aktorëve në nivel qendror dhe lokal dhe se përkushtimi i komunave në këtë proces është me rëndësi thelbësore. Ato përvijojnë procesin e dorëzimit, shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për ndihmë në të mirë të të kthyerve, duke përfshirë ndërtimin e shtëpive, pakot higjienike dhe format e tjera të ndihmës humanitare. Ai përcakton që kërkesat duhet të dorëzohen tek ZKKK-të dhe pastaj të regjistrohen në bazën e të dhënave të MKK-së. Pasi që kërkesa të regjistrohet si e tillë, ZKKK është e obliguar që të themelojë një grup pune në nivel komunal, i cili, brenda dy javëve, duhet të vlerësojë vendndodhjen potenciale për kthim dhe përmbushjen e kriterëve nga parashtruesi. Vendimet më pas mblidhen nga MKK në nivel qendror, dhe shqyrtohen nga Komisioni Qendror Shqyrtues (KQSH); përcaktohet një proces i përzgjedhjes, i përbërë nga tetë faza dhe me tre opsione të mbështetjes për përfituesit.³⁰

Në shkurt të vitit 2014, MKK miratoi Strategjinë dhe planin e veprimit. Strategjia përmban katër objektiva strategjike: kthimin e qëndrueshëm të PZH-ve brenda Kosovës dhe në rajon; fuqizimin dhe stabilizimin e komuniteteve në Kosovë; hartimin dhe ndryshimin e kuadrit ligjor të MKK-së që ka të bëjë me komunitetet, kthimin dhe riintegrimin, si dhe përmirësimin e menaxhimit të brendshëm në MKK. Për sa i përket kthimit të qëndrueshëm, Strategjia përcakton disa masa, duke përfshirë: ndihmën për PZH-të të cilët janë të interesuar të kthehen (sipas udhëzimeve), posaçërisht për grupe të identifikuara të caktuara³¹ dhe mbylljen e qendrave kolektive; vendosjen e një bashkërendimi efektiv mes MKK dhe mekanizmave gjegjës, posaçërisht për dhënien e tokës dhe gjetjen e zgjidhjeve për vendbanimet joformale, si dhe forcimin e mekanizmave për informim dhe ndërgjegjësim të PZH-ve dhe personave të kthyer. Strategjia parashikon përmirësimin e kornizës ligjore për komunitetet, kthimin dhe riintegrimin duke përfshirë krijimin e një kornize mbikëqyrëse. Së fundi, në strategji bëhen zotime për përmirësimin e menaxhimit të brendshëm në MKK dhe themelimin e mekanizmave të brendshëm ndërministrorë, me donatorë, rajonalë dhe ndërkombëtarë të

²⁸ Strategjia për komunitete dhe kthim dhe plani i veprimit (2014–2018), janar 2014, http://www.mkk-ks.org/repository/docs/Strategy_-_January_2014.pdf (qasur në shtator të vitit 2014). Strategjia e vitit 2014 u miratua me skadimin e Strategjisë për komunitete dhe kthim 2009–2014.

²⁹ Në vitin 2010, MKK nisi rishikimin e doracakut me qëllim të thjeshtimit dhe harmonizimit të procedurave të nevojshme për të përfunduar dhe zbatuar programet dhe projektet e kthimit.

³⁰ Këto opsione janë: projektet e zbatuara nga MKK në bashkërendim me komunat, një gamë e gjerë e ndihmave; projektet shumësektoriale të kthimit që zbatohen përmes një agjencie partnere dhe ndihma në shkallë të vogël për të mbështetur përfituesit me renovime a riparime të vogla të shtëpive. Udhëzimet, fusnota 27 më sipër.

³¹ Domethënë, familjet e zhvendosura të cilat jetojnë në qendra kolektive apo banesa private, për OJQ dhe grupet në pozitë të pafavorshme të PZH si dhe komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës.

bashkërendimit; realizimin e monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të avancuar të veprimtarive dhe projekteve; sigurimin e menaxhimit funksional dhe të përditësuar të dhënave dhe ndarjen e tyre, si dhe arritjen e një financimi më të madh për komunitete dhe kthim.

Strategjia e vitit 2014 siguron objektiva dhe masa më koherente se strategjia e mëparshme, që mbulonte periudhën 2010–2013.³² Strategjia aktuale merr parasysh kritikën e bëra më herët³³ duke trajtuar çështje si qëndrueshmëria e kthimit dhe perspektiva e zhvillimit ekonomik, ndarja e tokës, proceset e përzgjedhjes, mbyllja e qendrave kolektive si dhe bashkërendimi institucional dhe menaxhimi i të dhënave. Plani i veprimit, i cili është Shtojcë e strategjisë, është strukturuar ashtu që t'i identifikojë veprimet që duhet të ndërmerren, treguesit e suksesit, institucionet përgjegjëse dhe përkrahëse, afatet dhe koston financiare për realizimin e tyre. Megjithatë, nuk paraqiten hollësi për masat e veçanta, zbërthimin e afateve kohore dhe të burimeve njerëzore dhe financiare që nevojiten për jetësimin e planit të veprimit.

3.2 Rishikimi i zbatimit të veprimeve në mbështetje të kthimit të qëndrueshëm

Në pjesët në vijim shtjellohet themelimi dhe funksionimi i mekanizmave përgjegjës për jetësimin e kthimit dhe ndihmës për riintegrim në nivel lokal, gjegjësisht ZKKK-ve, grupeve punuese dhe task-forcës për kthim. Po ashtu, në këto pjesë shtjellohet edhe zhvillimi dhe përdorimi i strategjive komunale për kthim, si dhe veprimtaria e akterit kryesor në nivel qendror, MKK-së.

3.2.1 Zyrat komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK)

Si mekanizëm kyç me përgjegjësi të zbatimit praktik të përkrahjes për kthim, ZKKK-të janë organe të rëndësishme thelbësore.³⁴ Është detyrim i obligueshëm i komunave që t'i themelojnë zyrtarisht këto zyra dhe që të sigurojnë se ato kanë kuadro të duhur dhe se janë funksionale.³⁵ Vlerësimet në terren të OSBE-së tregojnë se deri në fund të qershorit të vitit 2014, ZKKK-të janë themeluar në 34 komuna.³⁶

Të dhënat nga monitorimi i OSBE-së janë shfrytëzuar për ta rishikuar funksionimin e ZKKK-ve gjatë periudhës së raportimit në lidhje me katër detyra kryesore: i) informimin dhe vlerësimin e nevojave, ii) mundësimin e vizitave shko-dhe-shih (VSHSH) dhe të vizitave shko-dhe-informohu (VSHI), iii) pjesëmarrjen në veprimtaritë e ndërlidhura me kthimin, dhe iv) realizimin e aktiviteteve në përkrahje të kthimit (po ashtu duke i referuar aktiviteteve që janë ndërmarrë nga organizatat e tjera). Shtojca I përmban tabelën ku paraqiten gjetjet për çdo komunë.

Një përgjegjësi e rëndësishme e ZKKK-ve është monitorimi i gjendjes së PZH-ve dhe të kthyerve të cilët jetojnë në komunat e tyre, duke kontaktuar me ta dhe vlerësuar nevojat e tyre

³² Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2009–2013, http://www.kryeministri-ks.net/zck/repository/docs/Strategy_for_Communities_and>Returns_2009-2013.pdf (qasur më 15 shtator 2014).

³³ Shih për shembull “Gjetjet paraprake të vlerësimit për komunitetet dhe kthimin 2009–2013”, ECMI, 11 shtator 2013, <http://www.ecmikosovo.org/?p=4990> (qasur më 15 shtator 2014).

³⁴ ZKKK janë “organi kryesor për përkrahjen e personave të cilët kthehen në Kosovë”, Udhëzimet, fusnota 27 më sipër.

³⁵ Rregullorja nr. 2010/02, nenet 1, 5 dhe 10, fusnota 21 më sipër.

³⁶ ZKKK nuk është themeluar në Malishevë, megjithatë komuna ka emëruar një zyrtar për të kryer detyrat e ZKKK-së. ZKKK nuk është themeluar në katër komunat veriore, Leposavic/Leposaviq, Zvečan/Zveçan, Zubin Potok, Mitrovica/Mitrovicën veriore, ndonëse ato kanë ruajtur strukturat e UNMIK-ut për komunitetet, pra Zyrën Komunale për Komunitete (ZKK) që kryen disa detyra të ZKKK duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me kthimin. Edhe pse ZKKK nuk janë themeluar, vlerësimi mbulon edhe këto komuna përkitazi me funksionet kyçe në përkrahje të kthimit.

dhe në bazë të këtyre të ofrojnë ndihmë, sipas nevojës.³⁷ Nga 34 ZKKK-të që iu nënshtruan vlerësimit, vetëm në 11³⁸ u realizuan vizita kontaktuese te të kthyerit apo PZH-të për t'i vlerësuar nevojat dhe për të ofruar informata, dhe nga këto 11, vizitat janë realizuar më pak se një herë gjatë periudhës për të cilën po raportohet, apo vetëm me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare apo OJQ-ve vendore.

Sipas gjetjeve të OSBE-së, ZKKK-të së bashku me zyrat e tjera gjegjëse komunale morën pjesë pothuajse në të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me kthimin e që u organizuan nga aktorët e tjerë, si VSHSH dhe VSHI (zakonisht të organizuara nga UNHCR, IOM apo KDR), mbledhjet e mekanizmave komunalë për kthim, takimet e komuniteteve për të diskutuar kthimin ose edhe në aktivitete të tjera në mbështetje të zbatimit të projekteve të kthimit. Duke qenë që një nga detyrat kryesore të ZKKK-ve është hartimi, zbatimi dhe monitorimi i projekteve³⁹ për promovimin e të drejtave të komuniteteve për të gëzuar qasje në shërbimet publike dhe për të përkrahur kushtet për kthim dhe riintegrim të qëndrueshëm, duket se vetëm disa prej tyre në të vërtetë realizojnë aktivitete të tilla me iniciativë të vet. Monitorimi në terren i OSBE-së ka konstatuar se asnjë nga ZKKK-të nuk ka realizuar aktivitetet e projekteve përtej përkrahjes së tyre të zakonshme në zbatimin e projekteve të kthimit të MKK-së apo atyre të udhëhequra nga donatorët që kryesisht përbëheshin nga donacionet e vogla apo puna infrastrukturore.

ZKKK-ve janë të obliguara që të raportojnë rregullisht te kryetari i komunës, kuvendi i komunës dhe institucionet qeveritare të nivelit qendror mbi përparimin e shënuar në fushën e kthimit, riatdhesimit dhe riintegrimin, si dhe për çështjet më të përgjithshme të të drejtave të komuniteteve.⁴⁰ Institucionet e nivelit qendror, jozyrtarisht, i kanë udhëzuar ZKKK-të që të hartojnë raporte mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore, si dhe u kanë siguruar atyre formularë të veçantë për raportim.⁴¹ Sipas të dhënave të OSBE-së, është shënuar përmirësim i ndjeshëm për sa i përket respektimit të obligimeve për raportim nga ana e ZKKK-ve, me një rritje nga 11 në 27 ZKKK që raportojnë rregullisht në korrik 2014⁴². Përderisa ky zhvillim është shumë pozitiv, një numër i vogël raportesh që janë shqyrtuar nga OSBE-ja përfshinin hollësi të pakta, kryesisht me një listë me numra të të kthyerve dhe të personave që kishin përfituar ndihmë.

3.2.2 Grupet punuese komunale për kthim (GPKK)

Përgjegjësi parësore e GPKK-së është të bashkërendojë dhe zbatojë të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me kthimin në komunë, si dhe ta promovojë komunikimin midis PZH-ve dhe komunitetit të tyre amë⁴³. GPKK kryesohet nga kryetari i komunës dhe duhet të mblidhet një herë në muaj. Në përbërjen e vet ka pjesëtarë të komuniteteve pritëse dhe atyre që kthehen, institucione dhe organizata ndërkombëtare përkatëse. Vlerësimet e deritanishme në terren të bëra nga OSBE-ja vënë në dukje që nga 38 komuna, ZKKK-të janë themeluar në 28 sosh.

³⁷ Rregullorja nr. 2010/02, nenet 7 dhe 9, fusnota 21 më sipër; udhëzimet, paragrafi 4, fusnota 27 më sipër.

³⁸ Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Novo Brdo/Novobërdë, Parteš/Partesh, Ranilug/Ranillug, Podujevë/Podujevo, Klinë/Klina, Gračanica/Graçanicë, Lipjan/Lipljan, Prizren.

³⁹ Rregullorja nr. 2010/02, neni 7(1.7), fusnota 21 më sipër.

⁴⁰ Rregullorja nr. 2010/02, neni 9(1.6), fusnota 21 më sipër.

⁴¹ Ky formular është relativisht i thjeshtë dhe është hartuar për t'i mundësuar ZKKK raportimin në MKK, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrën për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit.

⁴² Periudha krahasuese ka qenë nga janari 2013 deri korrik 2014. Tri komunat që nuk raportojnë rregullisht janë Parteš/Parteshi, Vushtrria/Vučitrn and Gračanica/Graçanica. Ndërkaq Mamuša/Mamusha/Mamuša, Malisheva/Mališevo, Deçani/Dečane and Juniku nuk kanë raportuar fare.

⁴³ Shih Doracakun, shënimi i 26-të i mësipërm.

Vetëm 10 nga to janë funksionale, në kuptimin që ato mblidhen për të vendosur përkitazi me ndihmën për të kthyerit dhe për të diskutuar për riintegrimin e tyre. Megjithatë, disa GPKK funksionale nuk e respektojnë detyrimin për të mbajtur takime të përmuajshme, ashtu siç parashihet nga Doracakun. Për shembull, nga 10 GPKK-të funksionale, vetëm tri kanë mbajtur të paktën një mbledhje brenda tre muajve.⁴⁴ Gjithashtu, përdërisa përbërja zyrtare e GPKK-ve është përgjithësisht në përputhje me Doracakun⁴⁵, në praktikë, OSBE-ja ka vërejtur shumë raste të mospjesëmarrjes apo mospërfaqësimit të komuniteteve pritëse dhe të kthyerve të potencialë.

3.2.3 Task forcat komunale për kthim

Task forcat komunale për kthim (task forcat) organizohen dhe udhëhiqen nga ZKKK-ja, dhe roli kryesor i tyre është ta mbështetin GPKK-në në punën e tij me vlerësimin dhe shqyrtimin e kërkesave individuale të PZH-ve për ndihmë⁴⁶. Sipas monitorimeve të OSBE-së, nga 38 komuna, task forcat janë themeluar në 21 sosh dhe përbëhen nga koordinatorët dhe zyrtarët komunalë për kthim, përfaqësuesi i MKK-së, UNHCR-së, dhe, ashtu siç është paraparë nga Udhëzuesi, përfaqësues të të gjitha organizatave ndërkombëtare apo OJQ-ve përkatëse që janë partnere në projektet përkatëse⁴⁷. Task forcat kryesisht punojnë me projekte dhe përfshijnë vlerësimet para kthimit dhe zbatimin e ndihmave. Task forcat përgjithësisht janë vlerësuar si funksionale nga organizatat përkatëse ndërkombëtare si IOM, UNHCR dhe KDR, të cilat zbatojnë projekte në fushën e kthimit⁴⁸.

3.2.4 Strategjitë komunale për kthimin

Bazuar në Doracakun e vitit 2006 për kthimin, nga komunat kërkohet që ta miratojnë dhe zbatojnë një strategji komunale për kthim ashtu që të kenë synime dhe aktivitete të qarta në mbështetje të kthimit dhe riintegrimin të PZH-ve në komunë⁴⁹. ZKKK-të bashkërendojnë procesin e hartimit të strategjive, duke i angazhuar drejtoritë komunale përkatëse dhe anëtarët e GPKK-së. Strategjitë më pas miratohen nga ana e GPKK-së. Për vitin 2014 deri tani vetëm pesë komuna⁵⁰ kanë miratuar strategji komunale dhe/ose plane veprimi për kthimin përdërisa tri komuna tjera⁵¹ kanë hartuar drafte (të cilat presin të miratohen), ndonëse asnjëra nuk ka ndarë buxhet përkatës. Komunat në fjalë ose nuk i kishin hartuara fare raportet e progresit në zbatim të strategjive komunale dhe/ose planeve të veprimit, ose nuk i kishin vënë ato në dispozicion, prandaj nuk ka informata të qarta për shkallën e zbatimit dhe ndikimit të këtyre strategjive në kthimin dhe riintegrimin e personave të zhvendosur. Megjithatë, në kuadër të raportimit të tyre të rregullt, ZKKK-të i raportojnë rregullisht kuvendit komunal, kryetarit të komunës dhe institucioneve qendrore në lidhje me aktivitetet e strategjisë. Zbatimi i strategjive zakonisht është i kufizuar në bashkëpunimin me projekte për kthim që financohen

⁴⁴ Dhjetë GPKK-të funksionale janë ato të Ferizajt/Uroševac, Novo Brdo/Novobërdës, Parteš/Parteshit, Štrpce/Shtërpçës, Fushë Kosovës/Kosovo Polje, Lipjanit/Lipljan, Obiliqit/Obilić, Shtimes/Štimlje, Prishtinës/Priština, Prizrenit. Tri komunat që kanë mbajtur një mbledhje gjatë periudhës tremujore prill-qershor 2014 janë: Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Obiliq/Obilić.

⁴⁵ Shih Doracakun, shënimi i 26-të i mësipërm.

⁴⁶ Udhëzimet, paragrafët 4 dhe 5, shënimi i 27-të i mësipërm.

⁴⁷ Udhëzimet, paragrafi 5, shënimi i 27-të i mësipërm.

⁴⁸ Në kohën e hartimit të këtij raporti, OSBE-së i mungojnë informatat e nevojshme për të vlerësuar nëse task forcat po i shqyrtojnë kërkesat dhe caktojnë ndonjë lokacion të mundshëm për kthim brenda afatit dyjavor të përcaktuar nga Udhëzimet.

⁴⁹ Shih Doracakun, shënimi i 26-të i mësipërm.

⁵⁰ Gjilan/Gnjilane (2012–2014), Parteš/Partesh (2012–2014), Lipjan/Lipljan (2014), Obiliq/Obilić (2014), Prizren (2012–2015)

⁵¹ Ferizaj/Uroševac (2014), Novobërdë (2014–2018). Ferizaj/Uroševac (2014), Ranilug/Ranillug (Plani i veprimit, 2014–2016), Novo Brdo/Novobërdë (2014–2018).

nga donatorët, si dhe në pjesëmarrjen e komunave në aktivitete që kanë të bëjnë me kthimin e që organizohen nga akterë të jashtëm, siç janë VSHSH-të dhe VSHI-të.

3.2.5 Funksionimi i përgjithshëm i mekanizmave komunalë

Përmbledhtazi, vlerësimet e OSBE-së në terren tregojnë që, ndonëse mekanizmat janë menduar që ta plotësojnë njëri-tjetrin për një mbështetje sa më efektive për të kthyerit dhe PZH-të në nivel lokal, në realitet, gjërat shpeshherë qëndrojnë ndryshe. Në nëntë komuna, task forca është i vetmi mekanizëm funksional, kjo sepse GPKK-ja ose nuk është themeluar fare ose nuk është funksionale⁵². Ndonëse task forcat nëpër këto komuna i kryejnë detyrat e GPKK-së në lidhje me procedimin e kërkesave për ndihmë, ato nuk mund të sigurojnë forum për dialog dhe pajtim ndërmjet të të kthyerve dhe komuniteteve pritëse, gjë që është detyrë qenësore e GPKK-së në shërbim të kthimit të qëndrueshëm. Më pak se gjysma e GPKK-ve të themeluara (10 nga 28) janë funksionale dhe mbështeten nga një task forcë⁵³. Në pesëmbëdhjetë komuna, ZKKK-ja është e vetmja që merret me kthimin⁵⁴. Nga këto komuna, tetë kanë mbi 100 PZH dhe persona të cilët janë të interesuar të kthehen⁵⁵. Shtojca II përmban një tabelë në të cilën janë paraqitur përmbledhtazi mekanizmat e ndryshëm që funksionojnë në çdo komunë.

3.2.6 Ministria dhe mekanizmat në nivel qendror

MKK ka mandatin kryesor për kthimin e personave të zhvendosur, ndonëse nuk është emëruar zyrtarisht si pikë institucionale kontakti në nivel Kosove për sa i përket zhvendosjes brenda vendit. Ministria është përgjegjëse për hartimin, promovimin dhe zbatimin e kornizës ligjore e cila ofron mbrojtjen e të drejtave të të kthyerve, për të promovuar kushte të favorshme për kthim, për të prirë me ndërtimin e mirëbesimit dhe nxitjen e dialogut mes komuniteteve, për të hartuar dhe menaxhuar programe dhe mekanizma për lehtësimin e integritit të komuniteteve, si dhe për t'i bashkërenduar planet dhe ndihmën në këto fusha.

Përkitazi me kthimin, MKK i mbështetë komunat në vlerësimin e kërkesave për ndihmë për kthim dhe në dorëzimin e këtyre kërkesave te komisionet qendrore që janë pjesë e zinxhirit të vendimmarrjes për projekte të mëdha të zbatuara nga donatorët. Megjithatë, monitorimi i paqartë dhe mangësitë në mbledhjen e të dhënave çungojnë kapacitetin e MKK-së për të vlerësuar dhe raportuar rreth zbatimit të politikave dhe projekteve për kthim në nivel Kosove. Ka nevojë për menaxhim të centralizuar të të dhënave nën udhëheqje të MKK-së, si dhe për mbledhje dhe analizim të informatave nga niveli lokal dhe ZKKK-të. Një sistem i këtillë nën menaxhim të MKK-së mund të ofrojë një pasqyrë të hollësishme të nevojave dhe profileve (përfshirë zberthimin sipas gjinisë), si dhe një sistem të përbashkuar dhe të centralizuar të menaxhimit të rasteve ku do të regjistroheshin informatat nga niveli lokal dhe ai qendror. Derisa komunat deklarohen që i raportojnë rregullisht MKK-së, ashtu siç kërkohet nga to, nuk është e qartë se si MKK i përpunon këto raporte për qëllime të vlerësimit dhe zhvillimit të politikave.

⁵² Klokot/Kllokot, Ranilug/Ranillug, Deçan/Deçane, Gjakovë/Dakovica, Klinë/Klina, Pejë/Peć, Gračanica/Gračanicë, Dragash/Dragaš, Rahovec/Orahovac.

⁵³ Ferizaj/Uroševac, Novo Brdo/Novobërdë, Partë/Partesh, Štrpce/Shtërpçë, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Lipjan/Lipljan, Shtime/Štimlje, Prishtinë/Priština, Obiliq/Obilić, Prizren.

⁵⁴ Hani i Elezit/Elez Han, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Viti/Vitina, Leposavić/Leposaviq, Mitrovicë/Mitrovica South, Mitrovica/Mitrovicë North, Zubin Potok, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Zvečan/Zvečan, Gillogoc/Glogovac, Podujevë/Podujevo, Malishevë/Mališevo, Mamuša/Mamushë/Mamuša.

⁵⁵ Mitrovicë/Mitrovica South, Mitrovica/Mitrovicë North, Leposavić/Leposaviq, Vushtrri/Vučitrn, Zubin Potok, Zvečan/Zvečan, Rahovec/Orahovac, Suharekë/Suva Reka.

Qëkurse u miratua më herët këtë vit, zbatimi i Strategjisë është përqendruar kryesisht në realizimin e projekteve të kthimit që financohen nga donatorët, gjegjësisht projektit për kthim dhe riintegrim të financuar nga BE-ja (RRK III), si dhe në stabilizimin e komuniteteve⁵⁶. Siç u përmend më sipër, MKK gjithashtu ka bërë hapa konkretë për ta avancuar kuadrin ligjor për zhvendosjen brenda vendit, duke themeluar një grup punues për hartimin e një instrumenti ligjor/të politikave për personat e zhvendosur brenda Kosovës. Bazuar në rekomandimin e grupit punues, MKK-ja në bashkëpunim me UNHCR-in dhe KDR-në, ka nisur një projekt për profilizimin e PZH-ve. Profilizimi, do të ofrojë të dhëna të zbërthyerë për popullatën e zhvendosur brenda Kosovës, duke përfshirë të dhëna mbi gjininë e tyre, nevojat dhe dobësitë, si dhe do të shoqërohen me një analizë ligjore. Përveç themelimit së këtij grupi punues, MKK-ja nuk ka bërë ende asnjë hap tjetër qoftë për ta përmirësuar kuadrin ligjor mbi kthimin dhe integrimin, qoftë për të vendosur kornizat e monitorimit të zbatimit të legjislacionit përkatës⁵⁷. Nuk është ndërmarrë asnjë nismë për t'i përmirësuar qoftë menaxhimin e brendshëm të MKK-së, qoftë masat e tjera të parapara me Strategji, duke përfshirë këtu përmirësimin e bashkërendimit me institucionet e tjera të Kosovës përmes një komisioni ndërministror bashkërendues⁵⁸, përmirësimin e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit, dhe ende mbete të krijohet një baze qendrore e të dhënave mbi kthimet.

4. ÇËSHTJET PRONËSORE

Është vërejtur përparim i kufizuar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të PZH-ve në pronë dhe banim, pavarësisht miratimit të kornizës ligjore parësore e dytësore dhe politikave, si dhe përpjekjeve të institucioneve qendrore dhe atyre lokale për ta përmirësuar mbrojtjen e të drejtave në pronë dhe banim përmes respektimit të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Monitorimi i OSBE-së në terren i ka identifikuar problemet kryesore që ndikojnë në të drejtat e PZH-ve në pronë dhe vendimin e tyre për tu kthyer, si në vijim: moszgjidhja e ankesave rreth pronësisë që kanë të bëjnë me konfliktin; tatimi i akumuluar në pronën e paluajtshme; shpronësimi; ndarja e parcelave për PZH-të të cilët para zhvendosjes nuk kanë pasur pronë apo çfarëdolloj të drejte tjetër të shfrytëzimit të njohur me ligj; dështimi për t'i njohur të drejtat e atyre të cilët, përpara se të zhvendoseshin, jetonin në vendbanime joformale; rregullimi i vendbanimeve joformale; dhe qasja në banim social.

Pranimi, regjistrimi dhe zgjidhja e një kategorie specifike të kërkesave pronësore që kishin të bënin me konfliktin për periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999 ishte në mandatin e Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP)⁵⁹. Deri më 31 gusht 2014, AKP-ja i

⁵⁶ Shih shënimet 18, 17, 16 më sipër.

⁵⁷ Shih Strategjinë, shënimin i 28-të i mësipërm, masa 3.2.

⁵⁸ Në mungesë të mekanizmave formal për bashkërendim ndërinstitucional të veprimeve lidhur me kthimin, puna e MKK-së varet nga nismat *ad-hoc*. Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit ka zbatuar gjithashtu ca projekte të vogla në ndihmë të të kthyerve, si dhe ka ndërmarrë nismë të përbashkët me MKK-në për bashkërendim në lidhje me përkrahjen nga donatorët, përfshirë përmes një mbledhjeje të mbajtur më 14 mars 2014. MKK, ZÇK, Këshilli Konsultativ për Komunitete dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kanë hartuar dhe nënshkruar një dokument të përbashkët për përkrahjen e komuniteteve në përgjithësi, si pjesë e një nisme të ndërmarrë në vitin 2013: "Angazhimi në ngritjen e bashkëpunimit dhe komunikimit në mes të institucioneve të nivelit qendror të cilat iu shërbejnë komuniteteve në Kosovë", qershor 2013; http://kryeministri-ks.net/zck/repository/docs/Joint_document_final.pdf (qasur më 15 shtator 2014).

⁵⁹ Pjesa 3 e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr 03/L-079 për zgjidhjen e kërkesave në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, 15 qershor 2008.

kishte zgjidhur më se 96 për qind të këtyre kërkesave⁶⁰; megjithatë, AKP vazhdon të përballet me vështirësi të ndryshme në zbatimin e vendimeve që kanë të bëjnë me këto kërkesa, duke përfshirë mungesën e përkrahjes nga policia dhe ndërhyrjet e gjykatave të Kosovës në kompetencat e AKP-së⁶¹. Madje, në disa raste, edhe pse kishte vendim të AKP-së dhe ishte dëbuar uzurpuesi i paligjshëm, prona riuurpohej sërish në mënyrë të paligjshme.⁶² Vonesat në zbatimin e vendimeve të AKP-së ua pamundësojnë PZH-ve që t'i kthejnë në posedim pronat e veta dhe, si rrjedhojë, që ta gëzojnë pronën e tyre të papenguar dhe lirshëm.⁶³

Në anën tjetër, shumica e pronave të PZH-ve që janë uzurpuar në mënyrë të paligjshme vazhdojnë që t'i nënshtrohen tatimit në pronën e paluajtshme, ndërsa barra për të dëshmuar se nuk janë bartës të tatimit të akumuluar u bie përsipër PZH-ve.⁶⁴ Kjo çështje është rëndësi të madhe, duke ditur që pa dëshmi të pagesës së tatimit në pronë të kthyerit nuk mund të pajisen me dokumente nga institucionet e Kosovës, siç janë fletëposedimet apo lejet e ndërtimit dhe, kështu, u kufizohen mundësitë ekonomike.

Çështje tjetër shqetësuese e identifikuar është shpronësimi i pronave të PZH-ve, posaçërisht në kohën e ndërtimit të autostradës Vermicë-Merdarë. Gjatë këtij procesi, komuniteteve jo shqiptare, sidomos atyre të zhvendosur, u janë mohuar të drejtat. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk i ka njoftuar PZH-të se prona e tyre është objekt i shpronësimit, vendimet zyrtare nuk u janë dorëzuar personalisht dhe nuk janë përkthyer në gjuhën e tyre, ashtu siç parashihet me kornizën ligjore të Kosovës,⁶⁵ dhe PZH-të nuk janë informuar rreth mjeteve juridike në dispozicion.⁶⁶

Nismat komunale për ndarje të parcelave të tokës për PZH-të kanë vazhduar në vitin 2013 dhe 2014, kryesisht në kuadër të projekteve të donatorëve ndërkombëtarë apo nismave për (ri) ndërtimin e shtëpive. Megjithatë, monitorimi në terren i OSBE-së tregon që disa komuna nuk veprojnë në përputhje me ligjin⁶⁷, në rrethana kur ngurrojnë (apo nuk janë të paktën

⁶⁰ Agjencia Kosovare e Pronës, <http://www.kpaonline.org/default.asp> (qasur më 1 shtator 2014).

⁶¹ Në disa raste, gjykatat kanë shqyrtuar raste që kanë qenë qartazi kompetencë e AKP-së. Në shkurt të vitit 2008, Gjykata Themelore e Vitisë/Vitina solli një vendim lidhur me rastin nr. 274/06, mbi të cilin ishte vendosur më parë nga AKP-ja (rasti nr. 306.347).

⁶² Në raste të tilla, AKP iniciu procedurat e ridëbimit, e që shpesh është vështirë të realizohen për shkak të përkrahjes jo adekuate nga Policia dhe Prokuroria e Kosovës apo për shkak të mangësive procedural të vet AKP-së (p.sh. AKP nuk ia procedon rastet e riuurpimit të paligjshëm PK-së për zbatimin të njoftimit fillestar për dëbim dhe ridëbim të menjëhershëm), ndonëse nga monitorimi i OSBE-së del se bashkëpunimi në mes të policisë, gjyqësorit dhe zyrtarëve të nivelit qendror dhe atij lokal është përmirësuar paksa së fundmi. Gjithashtu, monitorimi ka identifikuar mangësi në procedim dhe zbatim për rastet e riuurpimit të paligjshëm. Pa përjashtim, prokuroritë dështojnë që ta marrin parasysh natyrën ndëretnike në këto raste dhe të kërkojnë ndëshkime shembullore ashtu që të parandalohen veprimet e tilla në të ardhmen. Veç kësaj, pavarësisht nga elementi ndëretnike dhe natyra e qartë e rasteve të riuurpimit të paligjshëm, gjykatat nuk i shqyrtojnë me urgjencë dhe dënimet shpesh nuk përkojnë me natyrën e rëndë të veprës. Sipas monitorimeve të OSBE-së, prej vitit 2008 deri 2013, AKP i paraqitur në prokurori gjithsej 326 raste të riuurpimit të pronës nën administrim të Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP).

⁶³ Neni 1 i Protokollit të parë të Konventës Evropiane për të Drejta dhe Liritë Themelore të Njeriut, që zbatohet drejtpërsëdrejti në Kosovë duke u mbështetur në nenin 22 të Kushtetutës, shënimi i 2-të i mësipërm.

⁶⁴ Projekti i BE-së, Përkrahje e mëtejme për refugjatët dhe PZHBV-të: Tatimimi i pronës së paluajtshme në Kosovë të personave të zhvendosur përbrenda vendit, në dispozicion në http://www.pravnapomoc.org/ceb/analysis_of_gaps_5.pdf (qasur më 10 tetor 2014).

⁶⁵ Ligji nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, 27 korrik 2006.

⁶⁶ Sipas Ligjit nr. 03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, 10 dhjetor 2010.

⁶⁷ Shih nenin 10, Ligji nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzimin dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, 22 nëntor 2012.

proaktive) për të ndarë tokë komunale për projekte të lidhura me kthimin, ndonëse kjo është parakusht kyç për shumicën e projekteve të financuara nga donatorët ndërkombëtarë.

Në disa raste, ndarja e tokës nuk ka qenë e mundur për shkak të mungesës së tokës në pronësi komunale dhe komunitetet përballen me vonesa të konsiderueshme kur iniciojnë procedura ose për këmbimin e tokës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ose kur kërkojnë tokë nga qeveria e Kosovës⁶⁸. Përveç kësaj, shumica e komunave ende nuk kanë të dhëna të sakta mbi pronat e tyre apo inventar të plotë të pronave në pronësi komunale⁶⁹, ose përballen me probleme nga komunitetet pranuese. Në një numër rastesh peticionet e dorëzuara nga komunitetet pranuese kundër ndarjes së planifikuar të tokës (të shtjelluara më poshtë në pjesën 6) kanë pasur ndikim të rëndë në kthimin e personave të zhvendosur, përfshirë edhe si rrjedhojë e procedurave të gjata të nevojshme për identifikimin e tokës alternative për ndarje.

Shumë romë, ashkali dhe egjiptianë të zhvendosur të Kosovës kanë jetuar në vendbanime joformale para zhvendosjes së tyre dhe për këtë arsye përballen me vështirësi për t'i dëshmuar të drejtat e tyre të banimit në lidhje me kthimin e tyre⁷⁰. Përveç kësaj, monitorimi i OSBE-së ka vërejtur përparim të pakët në rregullimin (legalizimin) e vendbanimeve joformale dhe shumica e komunave nuk kanë miratuar plane hapësinore, të cilat duhet t'i përfshijnë edhe vendbanimet joformale, siç kërkohet edhe me Ligjin për Planifikim Hapësinor⁷¹. Zyra e Kryeministrit ende nuk e ka aprovuar Strategjinë për Rregullimin e Vendbanimeve Joformale 2011-2015, dhe të gjithë personat e zhvendosur që duan të kthehen në këto vendbanime vazhdojnë të përballen me probleme me regjistrimin e titullit të pronës, lejet e ndërtimit, legalizimin e ndërtimeve, tatimin në pronë, etj.

Së fundi, Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit⁷² përfshin dispozita përmes së cilave familjet që janë të pastrehë si rezultat i dëmtimit të shtëpive gjatë konfliktit mund të përfitojnë nga banimi social. Sidoqoftë, dispozitat e ligjit akoma nuk janë përdorur për t'i

⁶⁸ Për ta lehtësuar problemin e mungesës së tokës në pronësi komunale, shumë komuna kanë nisur procedurat për këmbimin e tokës me AKP-në, apo kanë kërkuar nga qeveria e Kosovës që ta rikthejë pronësinë mbi asetet në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore sipas nenit 12 dhe 13 të Ligjit Nr 04 / L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, 22 nëntor 2012.

⁶⁹ Nga monitorimi i rregullt është vërejtur që komunitetet të cilat kanë përfunduar inventarët e pronës komunale kanë marrë hapa pozitivë në trajtimin e nevojave të banimit të personave të zhvendosur dhe të riatdhesuar që nuk kanë toka, përmes ndarjes së tokës. Komuna e Pejës/Peć dhe e Istogut/Istok (me mbështetje të USAID), arritën t'i përgjigjen kërkesave për ndarje të tokës të bëra nga PZH-të pa tokë në Mal të Zi, me ndarje në kohë të parcelave të tokës të regjistruara si prona komunale në inventar. Në anën tjetër, komuna e Gjakovës/Djakovica dhe Klinës/Klina nuk kanë përfunduar procesin e inventarizimit dhe nuk arritën të japin përgjigje në kohë për kërkesat për ndarje të tokës për projektet e lidhura me kthimin për shkak të problemeve në identifikimin e tokës komunale të përshtatshme për ndarje.

⁷⁰ Raportuesi i posaçëm për personat e zhvendosur brenda vendit e ka nënvizuar këtë problem në raportin e tij të qershorit 2014 për Kosovën: "Ndonëse shumica e personave të zhvendosur romë, ashkali dhe egjiptianë kanë pasur shtëpi private, të drejtat e tyre të zotërimit të tokës nuk janë regjistruar kurrë dhe ata nuk kishin dokumente personale dhe tituj pronësorë për shtëpitë e tyre. Shumica dërmuese e të kthyerve që nuk kanë prona janë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, dhe ata kanë gjithnjë e më shumë vështirësi për t'u përfshirë në projekte të rindërtimit të shtëpive. Rreth 30 për qind të të kthyerve romë, ashkali dhe egjiptianë përfundojnë në zhvendosje të dytë." Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, *Raporti i Raportuesit të Posaçëm për të Drejtat e Njeriut të Personave të Zhvendosur Brenda Vëndit: Misioni përcjellës në Serbi, duke përfshirë Kosovën*, 5 qershor 2014. Shih edhe Raportin e OSBE-së, *Vlerësimi i reagimeve komunale për vendbanimet joformale në Kosovë*, dhjetor 2011, në dispozicion në <http://www.osce.org/kosovo/86273> (qasur më 10 tetor 2014).

⁷¹ Ligji nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, 7 shtator 2013, neni 15 dhe 16. Shih po ashtu *Doracakun e MMPH për Rregullimin e Vendbanimeve Joformale në Kosovë*, tetor 2012. Përderisa një numër i vogël i komunave kanë miratuar plane hapësinore, në gusht të vitit 2013 janë bërë ndryshime në terminologji dhe formatin e dokumenteve të planifikimit hapësinor komunal dhe shumica e komunave ende nuk i kanë plotësuar kërkesat e reja.

⁷² Ligji nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, 25 shkurt 2010.

trajtuar nevojat urgjente për banim të personave të zhvendosur, për shembull, në rastet kur ata përballen me dëbim.⁷³

5. ÇËSHTJET E SIGURISË

5.1. Siguria për të kthyerit dhe në vendet e kthimit

OSBE-ja monitoron dhe evidenton⁷⁴ incidentet që ndikojnë në sigurinë e komuniteteve në Kosovë. Në periudhën gusht 2012 deri në korrik 2014, të shqyrtuar për analizim të aspekteve të sigurisë, OSBE-ja ka evidentuar 1,181 incidente të sigurisë që potencialisht kanë ndikuar në perceptimet e komuniteteve pakicë numerike në nivel komunal mbi sigurinë. Nga këto incidente, 232 raste (rreth 20 për qind të numrit të përgjithshëm të incidenteve) kanë prekur vendet e kthimit dhe kryesisht të kthyer serbë të Kosovës.

Në përgjithësi, incidentet që prekin vendet e kthimit më shpesh evidentohen në rajonin e Pejës, ndërsa më pak incidente janë evidentuar në rajonin e Prizrenit, Ferizajt dhe Mitrovicës. Incidentet që prekin të kthyerit dhe vendet e kthimit janë të ndryshme, nga vjedhje të vogla dhe dëme të vogla të pronës, e deri në raste më të rënda të vjedhjeve, shpeshherë duke pasur në shënjestër traktorët, makinerinë bujqësore dhe bagëtitë, vjedhjet me thyerje në shtëpitë e banuara dhe të pabanuara të të kthyerve apo në vendet e kthimit, okupimi apo uzurpimi i paligjshëm i banesave dhe tokës, ngacmimet verbale dhe fizike të të kthyerve, incidente me të shtëna me armë zjarri, si dhe vënie të zjarrit në shtëpitë e të kthyerve.

Monitorimi i OSBE-së ka evidentuar se lloji më i shpeshtë i incidenteve që prekin të kthyerit dhe vendet e kthimit janë vjedhjet që në shënjestër kanë shtëpitë e pabanuara të serbëve të Kosovës⁷⁵. Prona të lëna bosh për periudha të gjata kohe mund të jenë caqe të lehta, prandaj dhe përderisa vjedhjet e tilla mund të kenë vetëm motive ekonomike, reagimet e komunitetit tregojnë se incidentet e tilla dekurajojnë kthimet, sidomos kur autorët e veprave nuk identifikohen. Komunitetet e kthyerë gjithashtu preken nga vjedhje të përsëritura të vogla dhe dëmtime të pronave në zonat me banim të vazhdueshëm⁷⁶. Prerjet e paligjshme të pyjeve në pronësi private në vendet e kthimit kryesisht janë evidentuar në Pejë dhe Istog⁷⁷, dhe zakonisht gjatë muajve të verës, kur fillon prerja e druve të zjarrit për dimër. Incidentet që lidhen me këto aktivitete shkaktojnë shqetësime tek popullata lokale dhe mund të jenë të

⁷³ Për shembull, rastet e mbylljes së qendrave kolektive në komunat e Gjilanit/Gnjilane dhe Shtërpçës/Štrpce: pas privatizimit të qendrës kolektive, 'fabrika e frigoriferëve' në komunën e Gjilanit/Gnjilane është mbyllur dhe qendra kolektive 'Junik' Shtërpçë/Štrpce pritet të mbyllet në tetor 2014. Ndonëse janë arritur marrëveshje në mes të komunave dhe MKK-së në këto dy raste, zgjidhje të qëndrueshme për PZH-të që jetojnë në qendra kolektive ende nuk janë gjetur dhe zbatuar.

⁷⁴ Të dhënat e monitorimit të OSBE-së përfshijnë incidente të cilat konsiderohen që potencialisht ndikojnë mbi komunitetet të cilët janë në pakicë numerike në nivel komunal, duke përfshirë komunitetin shqiptar të Kosovës që jeton në komunat me shumicë serbe. Informatat mblidhen nga burime të ndryshme, si intervista të stafit të OSBE-së me anëtarët e komunitetit dhe zyrtarët komunalë, raporte nga organizata të tjera ndërkombëtare, raporte nga Policia e Kosovës, si dhe raporte të mediave.

⁷⁵ Dëme të dyerve dhe dritareve, vjedhje të pajisjeve shtëpiake dhe mobileve dhe të materialeve ushqimore janë raportuar shpeshherë. Në disa raste janë regjistruar edhe shkatërrime të puseve, gardheve të oborreve dhe objekteve të tjera në afërsi të shtëpive. Incidentet e tilla kanë ndodhur kryesisht në Klinë/Klina, Pejë/Peć, Ferizaj/Uroševac, dhe Istog/Istok.

⁷⁶ Për shembull, një pompë uji që përdorej nga të kthyerit serbë të Kosovës në fshatin Grapc në Klinë/Klina ishte vjedhur tetë herë në periudhën 2004 deri 2013. Pompa e fundit ishte vjedhur në dhjetor 2013 dhe është zëvendësuar përmes një donacioni nga MKK në korrik të vitit 2014. Autorët e këtyre vjedhjeve ende nuk janë identifikuar.

⁷⁷ Raportet zakonisht përfshijnë zonat rreth fshatrave Lëvoshë/Ljevoša Tuqep/Tučep, Kosh/Koš, Osojan/Osojane and Gurrakoc/Đurakovac.

vështira për policinë që t'i trajtojnë ato meqë duket se shpeshherë përfshijnë grupe të armatosura kriminale.

Kisha dhe objektet e trashëgimisë fetare, duke përfshirë edhe varrezat në vendet e kthimit, gjithashtu janë vënë në shënjestër⁷⁸, dhe vizitat në objektet fetare ortodokse serbe gjithashtu janë prekur nga incidente të sigurisë, më së fundi në gusht të vitit 2014.⁷⁹ Incidente më të rënda përfshijnë rastet e ngacmimeve të të kthyerit, duke përfshirë abuzime verbale dhe gjuajtje me gurë të shtëpive nga grupe apo individë të komuniteteve të tjera në Klinë dhe Pejë, si dhe fshatrat përreth⁸⁰. Në trembëdhjetë incidente të zjarrvënies janë djegur shtëpitë e pabanuara të serbëve të Kosovës në periudhën prej gushtit 2012 deri në korrik 2014⁸¹. Siç është diskutuar në pjesën 6, në lokacione të caktuara të kthimit, tensionet ndëretnike janë veçanërisht të larta. Incidente që përfshijnë protesta dhe bllokime të rrugëve janë evidentuar në Mitrovicë të veriut dhe Suharekë.⁸²

5.2 Reagimet e institucioneve të Kosovës ndaj incidenteve të sigurisë

Në shumicën e rasteve, të kthyerit i raportojnë incidentet në vendet e kthimit, si dhe incidentet që prekin objektet fetare tek Policia e Kosovës. Në këto raste, monitorimi i OSBE-së në terren ka treguar që PK-ja hap hetime. Megjithatë, në disa raste, anëtarët e komunitetit kanë theksuar se ndihen të dekurajuar që t'i raportojnë rastet, meqë nuk presin që kryerësit të identifikohen dhe kanë pak besim në PK për t'i informuar ata lidhur me hetimet e mëtejme si dhe nëse këto raste përfundojnë me ndjekje penale. Kjo mungesë e besimit ndërmjet të kthyerve dhe Policisë së Kosovës ndikon drejtpërsëdrejti në perceptimin e sigurisë së të kthyerve dhe mund të pengojë procesin e kthimit.

Shumica e incidenteve serioze të diskutuara më lartë, si zjarrvënia, incidentet me armë zjarri apo sulmet, janë dënuar nga kryetarët e komunave apo zyrtarët e tjerë të lartë komunalë. Ministri për Komunitete dhe Kthim publikon dënime të rregullta të incidenteve të tilla dhe në disa raste bën edhe vizita në terren. Megjithatë, monitorimi i OSBE-së tregon se jo të gjitha këto dënime të incidenteve arrijnë tek komunitetet e prekura apo popullata shumicë në këtë zonë. Deklaratat e dënimeve publike zakonisht vendosen në faqe të internetit apo tabela informuese dhe jo në media (transmetuese) lokale. Në përgjithësi, dënimet dhe vizitat e shpejta në terren nga zyrtarë të lartë janë me rëndësi të madhe në trajtimin e ndikimeve negative në perceptimet e sigurisë së të kthyerve si pasojë e incidenteve të sigurisë.

⁷⁸ Dritaret e Kishës Ortodokse Bablak/Babljak të Ferizajt /Uroševac ishin thyer në janar 2013 dhe tre herë në tre muaj rresht në vitin 2014, duke përfshirë një vjedhje në maj 2014. Dëmtimi i gurëve të varreve është raportuar në qytetin e Istogut dhe fshatrave përreth (fshatrat Oprashkë/Opraške, Zallq/Žač dhe Koš/Kosh).

⁷⁹ Monitorimi i OSBE-së gjithashtu ka vërejtur që të kthyerit që vizitojnë vendet e tyre të prejardhjes për ceremoni të varrimit janë përballur edhe me shqetësime të sigurisë. Në një rast të kohëve të fundit rreth 300 shqiptarë të Kosovës kanë bllokuar rrugën kur pelegrinët (duke përfshirë edhe të kthyer të mundshëm), u përpoqën të vizitojnë manastirin e shkatërruar në fshatin Mushtiste/Mušutište, komuna e Suharekës/Suva Reka më 28 gusht, vend ky ku janë shënuar incidente të sigurisë në të kaluarën.

⁸⁰ Fshatrat Osojan/Osojane, Žač/Zalç dhe Gremnik/Grebnik. Incidenti më i fundit i gurëzimit u raportua në komunën e Klinës, që kishte si cak të njëjtën familje dy herë brenda një periudhe dhjetëditore në korrik 2014.

⁸¹ Incidentet janë raportuar në: Dugajevë/Dugenjive, 3 dhjetor 2012; Qytetin e Rahovec/Orahovac, 29 nëntor 2012; Fushë Kosovë/Kosovo Polje, 14 nëntor 2012; Qytet të Pejë/Peć, 9 tetor 2012; Belopojë/Belo Polje, 16 dhe 21 janar 2013, dhe 7 tetor të 2013; Dresnik/Drnsnik, 6 janar 2013 dhe 9 shkurt 2014; Klinafç/Klinavac, 21 janar 2013 dhe 31 janar 2014; dhe Binxhë/Biča më 23 dhe 24 majit 2013.

⁸² Që nga fundi i vitit 2012, protestat dhe postbloquent kanë ndaluar ndërtimet e reja në Mitrovica/Mitrovicë të Veriut, pasi proceset paralele të ndërtimit të shtëpive për komunitetet shqiptare të Kosovës dhe serbëve të Kosovës në Brđani/ Kroin e Vitakut shkaktuan tensione; protesta të përsëritura janë organizuar nga të dyja palët më 2013 dhe 2014. Fshati Mushtiste/Mušutište në komunën e Suharekës/Suva Reka është një tjetër vend i kthimit që është prekur nga incidentet e vazhdueshme të sigurisë dhe protestat; shih incidentin 28 gusht 2014, shënim 79 më lartë.

Në mars të vitit 2013, PK-ja ka themeluar një njësi të specializuar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe objekteve fetare, me katër nën-njësi që ofrojnë mbrojtje 24-orëshe të 24 objekteve të trashëgimisë së Kishës Ortodokse Serbe, dhe rregullisht patrollojnë dhe vizitojnë 169 lokacionet në rajonin e Prishtinës, Mitrovicës, Pejës dhe Prizrenit. Një zhvillim tjetër pozitiv ishte përmirësimi i kohëve të fundit i përfaqësimit të komuniteteve dhe grupeve fetare në Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi (KKSBB). Monitorimi i OSBE-së vë në pah disa hapa të dobishëm përpara, ndonëse të kufizuar, lidhur me diskutimet e KKSBB-ve për çështjet e sigurisë që prekin komunitetet në pakicë numerike në nivel komunal⁸³ dhe marrjen e masave për të ndihmuar trajtimin e këtyre shqetësimeve.

6. SHQETËSIMET QË KANË TË BËJNË ME KOMUNITETET PRANUESE

Raporti i OSBE-së mbi kthimin vullnetar⁸⁴ i vitit 2012 nënvizoi që tensionet ndëretnike kanë çuar në zvarritje të procesit të kthimit në disa fusha dhe konkludoi se janë të nevojshme përpjekje më të mëdha nga të gjithë aktorët, në veçanti institucionet e Kosovës, për t'i trajtuar këto çështje dhe për ta ringjallur mbështetjen e zbehur politike për procesin e kthimit. Përfundimet e raportit të vitit 2012 vazhdojnë të jenë të vlefshme.

6.1 Kundërshtimi i komunitetit pranues ndaj kthimeve

Situata në 'lokacionet e vështira të kthimit' e identifikuar në raportin e vitit 2012 të OSBE-së⁸⁵, që mbulon rajonin e Prizrenit, Pejës, Ferizajt dhe Prishtinës, nuk është përmirësuar në masë të madhe në periudhën për të cilën po raportohet, pra gusht 2012 deri korrik 2014, me raste të protestave publike kundër kthimeve madje së fundmi në gusht 2014⁸⁶. Janë identifikuar lokacione të tjera të vështira, kryesisht në rajonin e Mitrovicës⁸⁷, ku procesi i kthimit të serbëve në jug dhe shqiptarëve në veri është tejet i politizuar dhe i rënduar nga incidentet e sigurisë⁸⁸. Në rajone të tjera, komunitetet pranuese në Pejë dhe Prizren kanë shprehur kundërshtim të fortë ndaj kthimit të serbëve të Kosovës⁸⁹, duke refuzuar që të kenë fare kontakt me të kthyerit potencialë dhe duke kundërshtuar organizimin e çdo nismë të kthimit, përfshirë këtu VSHSH apo VSHI.

⁸³ Shembuj pozitivë ku janë diskutuar probleme të sigurisë të komuniteteve në pakicë numerike në nivel komunal në takimet e KKSBB-ve janë vërejtur në Pejë dhe Dragash. Në përgjithësi, mbledhjet e KKSBB-ve të komunave të tjera përfshijn një raport të incidenteve përkatëse të sigurisë që ofrohej nga ana e policisë, por u mungon ndonjë veprim i përbashkët i komunitetit për t'i trajtuar shqetësimet.

⁸⁴ Shënimi 1 më lartë

⁸⁵ Lokacionet në vijim janë identifikuar si "lokacione të vështira për kthim": Kijevo/Kijevë dhe Mleçane/Mleqan, Komuna e Malishevës/Mališevo Dvoran/Dvorane, Lešane/Leshan, Mushtishtë/Mušutište dhe Sopina/Sopin (komuna e Suharekës/Suva Reka) në rajonin e Prizrenit. Komuna e Gjakovë/Đakovica, Drenovc/Drenovac, Dush/Duševići (Klinë/Klina), Ljubenić/Lubenić (komuna e Pejës/Peć), dhe Loçane/Loqan (Deçan/Dečane) në rajonin e Pejës/Pec. Slovinje/Slovi (komuna dhe rajoni i Prishtinës/Pristina). Neredime e Epërme/ Gornje Neredime (Komuna dhe rajoni i Ferizajt/Urosevac). Shih raportin e OSBE-së (2012), shënimi më lartë 1.

⁸⁶ Protesta publike ka pasur në Mushutishtë/Mušutište (Suharekë/Suva Reka) në gusht 2014.

⁸⁷ Lokacionet e regjistruara janë: Vërmicë/Vrnica (Komuna e Vushtrrisë/Vucitn), Kroj Vitakut/Brđjani (Komuna e Mitrovicës/Mitrovica), dhe fshatrat Runik/Rudnik dhe Kuqice/Kucica (komuna Skenderaj/Serbica).

⁸⁸ Në Brđani/Kroj i Vitakut në Mitrovica/Mitrovicë të Veriut, ku procesi i kthimit është iniciuar nga komuna e Mitrovicës /Mitrovica së Jugut në fund të vitit 2012, janë ngritur tensione gjatë periudhës raportuese. Ndërtimi i shtëpive për familjet e shqiptarëve të Kosovës ka filluar, gjë që nuk është pranuar nga komuniteti pritisë serb i Kosovës, të cilët protestuan, vendosen blloqe në rrugë dhe penguan ndërtimin e shtëpive në mënyra të ndryshme. Në të njëjtën kohë, ndërtimi i objekteve për serbët e Kosovës filloi me fonde nga qeveria serbe. Kanë ndodhur disa incidente si dëmtimi i shtëpive të reja dhe atyre të papërfunduara.

⁸⁹ Rastet përfshijnë: Korishë/Koriša (Prizren), Talinoc i Muhaxherëve/Muhadjer Talinovac (Komuna e Ferizajt/Urosevac), and Opterushë/Opteršua (Komuna e Rahovecit/Orahovac) dhe Shtupel/Štupelj (Klinë/Klina).

Për më tepër, gjatë periudhës raportuese komunitetet pranuese në gjashtë komuna⁹⁰ aktivisht kanë përgatitur peticione kundër kthimit të personave të zhvendosur. Në një rast, peticioni justifikohet në krime të pretenduara të luftës të kryera nga të kthyerit e mundshëm⁹¹. Peticione⁹² të tjera cituan shqetësimet e sigurisë dhe vërejtjet që personat e zhvendosur nuk janë me prejardhje nga lokacioni i caktuar i kthimit duke kundërshtuar ndarjen e tokës për të kthyerit romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës pa toka të zhvendosur në Mal të Zi dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

6.2 Reagimet komunale ndaj kundërshtimit të komuniteteve pritëse ndaj kthimit

Ndonëse komunat janë të obliguara të sigurojnë kushte për kthim të qëndrueshëm dhe stabilizim të komuniteteve⁹³, reagimet e tyre ndaj kundërshtimeve të komuniteteve pritëse kanë dalluar shumë nga rasti në rast. Në shumicën e lokacioneve të vështira për kthim, komunat nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për të ndërmjetësuar me komunitetet pritëse në përkrahje të procesit të kthimit⁹⁴, ndërsa raste të caktuara, zyrtarët kanë refuzuar të angazhohen në çfarëdo aktivitete të pajtimit edhe kur është ofruar përkrahja nga OSBE-ja apo organizata të tjera⁹⁵. Megjithatë, disa komuna kanë ndërmarrë hapa pozitivë dhe kanë arritur përparim të rëndësishëm, edhe kur kundërshtimi ndaj kthimit në të kaluarën ka qenë i konsiderueshëm.⁹⁶ Ngjashëm, gjithashtu ka raste ku përpjekjet e komunës për të mundësuar dialogun ndërmjet komuniteteve pritëse dhe të kthyerve potencialë kishin dështuar për shkak të vazhdimit të kundërshtimit ndaj kthimit⁹⁷. Në një rast, komuna ka ndërmarrë veprime për të mundësuar dialogun⁹⁸, në katër raste të tjera komunat kanë reaguar duke gjetur hapësira të tjera për ndarje të parcelave⁹⁹, ndërsa në një rast, komuna nuk ka ndërmarrë fare veprime në reagim ndaj një kundërshtimi të tillë¹⁰⁰.

Ka pasur raste ku ZKKK-ja, së bashku me kryetarët dhe nënkryetarët e komunave janë angazhuar në nisma të ndërtimit të besimit dhe kanë ndërmjetësuar në mes të komuniteteve pritëse dhe të kthyerve (potencialë) Siç ka qenë rasti në fshatin Plemetinë/Plemetina, në komunën e Obiliqit/Obilić. Megjithatë, nuk janë angazhuar mekanizma të tjerë komunalë për

⁹⁰ Istog/Istok (Muzhevinë/Muževine), dhe komunat e Gjakovës/Djakovica, Pejë/Peć, Obiliq/Obilić (Plemetinë/Plemetina), Klinës/Klina (Dresnik) dhe Istog/Istok.

⁹¹ Ky ishte rasti në fshatin Muzhevinë (komuna e Istogut): në nëntor 2012 komuniteti pritës dorëzoi peticion kundër kthimit të katër serbëve të Kosovës në fshatin e tyre, duke pretenduar se kanë kryer aktivitete kriminale gjatë konfliktit të vitit 1999.

⁹² Pesë raste të tjera të peticioneve kanë ndodhur në Gjakovë/Djakovica, Pejë/Peć, Obiliq/Obilić (Plemetinë/Plemetina), Klinës/Klina (Dresnik) dhe Istog/Istok.

⁹³ Shih Doracakun, para 19, *sipër*, shënimi 26.

⁹⁴ Nuk janë ndërmarrë veprime të tilla në: Kijevë/Kijevo, Mlecan/Mleqan (Komuna Malishevë), Dvoran/Dvorane, Lesane/Leshan dhe Sopino/Sopine (Komuna e Suharekës/Suva Reka), Komuna e Gjakovës/Djakovica, Drenovc/Drenovac, Jelovac/Jeloviq apo Dush/Duš (Komuna e Klinës/Klina), ose në Ljubenic/Lubeniç (Komuna e Pejë/Peć).

⁹⁵ Për shembull, në fshatrat Korishë/Koriša dhe Drenovc/Drenovac (komuna e Klinës/Klina).

⁹⁶ Nerodime e Epërmenë/Gornje Nerodime komunën e Ferizajt/Uroševac si dhe Mushutishtë/Mušutište në komunën e Suharekës/Suva Reka janë shembuj të përkrahjes komunale për kthimin, që ka çuar në përparim të rëndësishëm. Procesi i kthimit në fshatin Nerodime e Epërme/Gornje Nerodime u ndal në fillim të nëntorit 2010 kur komuniteti pritës shqiptar pengoi një VSHSH të serbëve duke organizuar një protestë me pretendime të krimeve të luftës. Këshilli i Fshatit Mushutishtë/Mušutište gjithashtu kundërshtonte kthimin, duke argumentuar që komuniteti pritës shqiptar nuk ishte ende i gatshëm për të pranuar këtë gjë.

⁹⁷ Dy shembuj të tillë janë Lloqan/Locane dhe Slovinje/Silovi në Komunën e Lipjanit/Lipljan, ku me përkrahjen e OSBE-së, ZKK-ja ka organizuar dy takime të ndara me komunitetet pritëse dhe të kthyerit potencialë por pa sukses.

⁹⁸ Në fshatin Plemetinë/Plemetina, Komuna Obiliq/Obilić (me përkrahje nga jashtë) ka organizuar takime më 2014 me të kthyerit potencialë dhe komunitetin pritës: iniciativa është në vazhdim, si dhe deri tani nuk ka arritur të adresojë kundërshtimin insistues nga komunitetet pritëse ndaj të kthyerve potencialë, të dy grupet nga komuniteti rom.

⁹⁹ Sidomos në Gjakovë/Djakovica, Pejë/Peć, Klinë/Klina (fshati Dresnik/Dresnik) si dhe Istog/Istok.

¹⁰⁰ Fshati Muzhevinë/Muževine, Komuna Istog/Istok.

komunitete, si GPKK-të, zëvendëskryesuesit e kuvendeve komunale për komunitete, komitetet për komunitete apo këshillat komunalë për siguri në bashkësi, edhe pse kjo është në përputhje me mandatet e tyre përkatëse për të siguruar integrimin e komuniteteve, dhe këto organe do të mund të kontribuonin në masë të konsiderueshme në procesin e ndërmjetësimit.

7. ASPEKTET RAJONALE

Për zhvendosjen si rrjedhojë e konflikteve të Ballkanit Perëndimor të viteve të 90-ta janë ndërmarrë përpjekje të shumta ndërkombëtare e rajonale, por asnjëra nuk kishte në fokus zhvendosjen nga Kosova¹⁰¹. Ndonëse është arritur një shkallë e bashkëpunimit bilateral, nuk ka pasur ndonjë marrëveshje gjithëpërfshirëse ndërmjet qeverive - bashkëpunimi në nivel rajonal nuk është ende sistematik, derisa mangësitë vazhdojnë të ndikojnë në kthim. Strategjia e Kosovës për Komunitete dhe Kthim 2014–2018 përfshin synimin strategjik të krijimit të mekanizmave koordinues me donatorë si dhe palë rajonale e ndërkombëtare me interes, por nuk liston veprime specifike për themelimin e këtyre mekanizmave.¹⁰²

7.1 Fushat kryesore të prekura nga bashkëpunimi rajonal

Janë një numër çështjesh në nivel rajonal që kanë nevojë për vëmendje dhe bashkëpunim të shtuar. Mbledhja dhe menaxhimi i të dhënave, dokumentacioni zyrtar dhe koordinimi për vizita në terren dhe angazhim me grupet e të zhvendosurve dhe individët janë tri fusha kryesore që kërkojnë angazhim rajonal. Në Ballkanin Perëndimor ka një bashkëpunim të dobët në nivel rajonal për sa i përket mbledhjes dhe menaxhimit të të dhënave. Koordinimi dhe shkëmbimi i dobët i informatave nënkupton që edhe 15 vite pas konfliktit të vitit 1999 në Kosovë nuk ka profilizim gjithëpërfshirës të personave të zhvendosur. Kjo pengon zhvillimin e programeve më të përshtatura të ndihmës dhe përzgjedhjen e mirëfilltë të përfituesve, duke përfshirë edhe rrezikun nga ndihma e gabuar.¹⁰³ Ngjashëm, shkëmbimi i dobët i informatave për numrin e personave të zhvendosur dhe të kthyerve potencialë gjithashtu përbën pengesë ndaj planifikimit efektiv, qoftë në kuptimin e kapacitetit të institucioneve për t'i paraprirë ndihmës për kthimin që do të kërkohej, qoftë në kuptimin e masave përkrahëse të domosdoshme për integrim në vendin e zhvendosjes.¹⁰⁴

Dokumentacioni zyrtar është një fushë tjetër kyçe që kërkon vëmendje dhe bashkëpunim rajonal. Procedurat për pajisje me dokumentacion vazhdojnë të jenë të ndërlikuara dhe jo të njëtrajtshme, sidomos ato që kanë të bëjnë me nxjerrjen e dokumenteve, ndërsa mekanizmat institucionalë për trajtimin e çështjeve kontestuese (si vlefshmëria) kryesisht nuk ekzistojnë fare. Si rezultat, qasja problematike në dokumente zyrtare dhe përdorimi i dokumenteve zyrtare të lëshuara ose nga institucionet në vendet e prejardhjes ose nga ato në vendet e zhvendosjes sjell pasiguri juridike për ata që mundohen të regjistrohen, të dëshmojnë gjendjen e tyre civile, titujt pronësorë apo kualifikimet arsimore, ose ata që provojnë t'i respektojnë procedurat administrative dhe kriteret procedurale për kthim apo ndihmë sociale. Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve është gjithashtu qenësor për ata të zhvendosur që duan të integrohen në vendet e zhvendosjes: dokumentet e shumta që ky proces kërkon të cilat

¹⁰¹ Mali i Zi është megjithatë i vetmi vend që ka përfshirë personat e zhvendosur nga Kosova në Programin Rajonal të Strehimit, të përcaktuar përmes procesit të Sarajevës për personat e zhvendosur gjatë 1991-1995.

¹⁰² Shih Strategjinë, masa 4. 2, *sipër*, shënimi 28

¹⁰³ Për shembull, kur personat e zhvendosur aplikojnë për ndihmë në vendin e origjinës dhe vendin e zhvendosjes, ose kërkojnë ndihmë disa herë me radhë.

¹⁰⁴ Megjithatë ka disa aspekte të të dhënave që duhet të mbahen në kuadër të institucioneve, për shembull të dhënat që lidhen me kërkesat e mundshme individuale për azil.

mund të merren vetëm nga institucionet qeveritare¹⁰⁵. Situatat e tilla përbëjnë sfidë të vërtetë, sidomos për ata persona të zhvendosur që kanë humbur të gjitha dokumentet dhe nuk kanë ndonjë akt për të dëshmuar ekzistencën e tyre juridike. Është e nevojshme të arrihet bashkëpunim dhe të ngrihen mekanizma sistematike rajonale për t'i lehtësuar këto procese administrative, duke përfshirë njohjen e ndërsjellë të dokumenteve zyrtare nga të gjitha institucionet e përfshira.

Gjithashtu mungojnë procedurat apo mekanizmat institucionalë për të shpërndarë informata lidhur me shqetësimet e personave të zhvendosur. Kjo ka rëndësi sidomos në lidhje me të drejtat pronësore, ku shumica e personave të zhvendosur ende nuk arrijnë të marrin informata të freskëta për statusin e pronës së tyre, duke pasur nevojë që të kërkojnë përmes kanaleve jointucionale e joformale dhe kontakteve me ON, OJQ apo shoqata të personave të zhvendosur. MKK-ja megjithatë synon të përforcojë ekipin e saj të informimit publik, si dhe planifikon botimin dhe shpërndarjen e broshurave tek personat e zhvendosur jashtë Kosovës dhe fushatën mediatike plotësuese¹⁰⁶, hapa që do duhej të ndihmonin në trajtimin e nevojave të tilla pasi të realizohen.

Në përgjithësi, është më se e nevojshme që të përmirësohet informimi dhe kontaktimi me personat e zhvendosur, të cilët shpeshherë duket se nuk kanë njohuri për të drejtat e tyre dhe mundësitë e ndihmës, si dhe të cilët kërkojnë informata nga të dy institucionet, në vendet e prejardhjes dhe vendin e zhvendosjes. VSHI-të dhe VSHSH-të janë, për shembull, mjete shumë të rëndësishme për përkrahjen e personave të zhvendosur drejt marrjes së vendimeve të rëndësishme, si dhe kërkojnë bashkëpunim ndërmjet institucioneve përkatëse.

7.2. Gjendja aktuale në kuptimin e bashkëpunimit rajonal

Megjithatë, bashkëpunimi rajonal është duke u përmirësuar ndërsa institucionet kanë shfaqur përkushtim më të madh ndaj homologëve të tyre rajonalë viteve të fundit. Bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi, si dhe ndërmjet Kosovës dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë realizohet rregullisht në nivel ministror në lidhje me ndihmën, p.sh për të siguruar qasje në regjistrimin civil dhe këmbimin e informatave për individët që janë të interesuar të kthehen në Kosovë. Memorandumet teknike bilaterale të mirëkuptimit që janë nënshkruar për realizimin e projekteve të ndihmës së financuara nga BE-ja janë indikacione të rëndësishme të përkushtimit dhe punës së përbashkët nga dy vendet e zhvendosjes.

Nga ana e Kosovës, MKK-ja dhe ZKKK-të ndërmarrin veprime të informimit për personat e zhvendosur jashtë Kosovës në Mal të Zi dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, për të ofruar informata drejtpërsëdrejti ose përmes institucioneve kompetente të vendit të zhvendosjes për t'u siguruar që personat e zhvendosur janë të informuar për kushtet e kthimit¹⁰⁷ përmes VSHI-ve dhe VSHSH-ve. institucionet e Kosovës gjithashtu pranojnë dhe regjistrojnë kërkesa për ndihmë në kthim përmes ZKKK-ve; megjithatë, në mungesë të ndonjë mekanizmi institucional me koordinim qendror për pranimin e kërkesave, kjo funksionon përmes kanaleve të ndryshme që përfshijnë vetë individët, degët e UNCHR-së, OJQ-të apo shoqatat e personave të zhvendosur, të cilët i dërgojnë kërkesat e personave të zhvendosur tek ZKKK-ja përkatëse. Institucionet kosovare

¹⁰⁵ Për shembull: dokumentet e gjendjes civile, vërtetimi zyrtar i punësimit të mëparshëm, kualifikimet arsimore, etj.

¹⁰⁶ Shih Strategjinë, 1.4.1, *supra*, fusnota 28.

¹⁰⁷ Si gjendja socio-ekonomike, siguria, perceptimet e komunitetit pritës, etj., për të ushqyer vendimet e personave të zhvendosur për të aplikuar për kthim, apo alternative, si integrimi lokal në vendin e zhvendosjes, apo vendosjen në një vend të tretë.

gjithashtu janë përgjegjëse për vlerësimin e kushteve të jetesës së aplikantëve dhe pronësinë e tyre, si pjesë e vendimmarrjes për ndihmë në kthim: kjo kërkon informata zyrtare nga institucionet në vendin e zhvendosjes. Bashkëpunimi ndërqeveritar për regjistrimin civil, me ekipe mobile të përbëra nga zyrtarë të Kosovës dhe Malit të Zi që bëjnë vizita në terren në Mal të Zi¹⁰⁸ janë dëshmuar si shumë të efektshme dhe shembull pozitiv i bashkëpunimit rajonal, me përfitime të drejtpërdrejta dhe praktike për personat e zhvendosur.

Pa bashkëpunim ndërmjet institucioneve në vendin e zhvendosjes dhe në vendin potencial të kthimit, do të ketë edhe më tej pengesa të rëndësishme deri në zbatimin e plotë të zgjidhjeve të qëndrueshme. Derisa shumë kërkesa duhen adresuar në nivel teknik, zotimet ndërqeveritare për bashkëpunim në nivel politik mund të jenë me vlerë të madhe në lehtësimin e përparimit në nivel pune.¹⁰⁹

8. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Përmbledhtazi, 15 vjet pas konfliktit të vitit 1999, përkundër ndihmës së konsiderueshme ndërkombëtare dhe programeve të fokusuara, një numër i madh i personave të zhvendosur brenda edhe jashtë Kosovës ende nuk kanë zgjidhje të qëndrueshme. Çdo vit ka rënie të numrit të të kthyerve në Kosovë. Kjo fushë vazhdon të jetë sfidë e rëndësishme për institucionet e Kosovës, si dhe prioritet në përpjekjet për integrim evropian.¹¹⁰

Janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në trajtimin e problemit të zhvendosjes nga Kosova si rrjedhojë e konfliktit, përmes zhvillimit institucional, ligjor dhe të politikave, si dhe është arritur progres në lidhje me kthimin. Megjithatë, shqyrtimi i kornizës ligjore dhe i politikave ka identifikuar mangësi të konsiderueshme në legjislacionin bazë dhe mangësi në dokumentet kryesore të politikave. Shqyrtimi i veprimeve të ndërmarra në përkrahje të kthimit ka konstatuar se komunat po dështojnë në përmbushjen e obligimeve të tyre, ku shumë mekanizma lokalë nuk funksionojnë mirë apo me rregull. Ngjashëm, MKK-ja duhet të përmirësojë performancën në disa fusha, sidomos në grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave, komunikimin dhe bashkërendimin me komuna dhe organet tjera të nivelit qendror. Çështjet pronësore pengojnë përparimin e kthimit në shumë mënyra, ku shumë persona të zhvendosur ndikohen ose nga pengesat në ushtrimin apo vërtetimin e pronësisë së tyre mbi pronën në vendet e prejardhjes, ose nga pengesat në ndarjen e parcelave për programe të ndihmës në banim. Incidentet e sigurisë vazhdojnë të ndikojnë te të kthyerit dhe lokacionet e kthimit si dhe perceptimet e komuniteteve për sigurinë, duke përfshirë dhe filluar nga incidentet e vogla e deri te vjedhjet më serioze, sulmet e zjarrvëniet. Kthimi gjithashtu ndikohet nga rezistenca e komuniteteve pritëse, të cilët kanë bllokuar kthimin e mundshëm në një numër lokacionesh në gjithë Kosovën. Përfundimisht, ende ka bashkëpunim të kufizuar ndërmjet institucioneve të Kosovës atyre të rajonit ku aktualisht jetojnë personat e zhvendosur nga Kosova; ndonëse bashkëpunimi i tillë është përmirësuar viteve të fundit,

¹⁰⁸ Kjo vizitë e përbashkët është kryer në maj të vitit 2014, si dhe ka rezultuar në regjistrimin e 135 individëve.

¹⁰⁹ Për shembull, “Procesi i Sarajevës” ka dëshmuar përkushtim politik të nivelit të lartë, pasuar nga takimet teknike për të krijuar zgjidhje për avancim të bashkëpunimit në adresim të zhvendosjes. Takimet teknike kanë rezultuar më vonë në një program rajonal banimi të financuar nga donatorë, menaxhuar bashkërisht nga katër shtetet e përfshira (Kroacia, Serbia, Bosnja e Hercegovina si dhe Mali i Zi).

¹¹⁰ Plani i Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE) 2012 për Kosovën përcakton masat dhe obligimin pozitiv të institucioneve të Kosovës që të “lehtësojnë dhe promovojnë kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur nga të gjitha komunitetet”. PVPE 2012, miratuar më 9 gusht 2006, f. 57. http://www.mei-ks.net/repository/docs/European_Partnership_Action_Plan_2012.pdf (qasur më 15 shtator 2014).

përparimi i mëtejshëm do të sjellë një spektër përfitimesh praktike e strategjike për procesin e kthimit.

Rekomandimet

Për institucionet në rajonin e Ballkanit Perëndimor, në veçanti Serbinë, Malin e Zi dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, me përgjegjësi për personat e zhvendosur dhe të kthyerit:

- Institucionet përkatëse të nivelit qendror duhet ta përmirësojnë bashkërendimin në shumë mënyra. Shkëmbimi i informatave dhe ndarja e të dhënave është e një rëndësie të veçantë, veçanërisht për të ndihmuar në planifikimin strategjik të programeve të ndihmës. Komunikimi është një fushë tjetër kyçe, e cila do të mund të përmirësohet me emërimin e personave kontaktues në ministritë apo agjencitë përkatëse si dhe mbajtjen e mbledhjeve teknike koordinuese.
- Institucionet përkatëse duhet të arrijnë marrëveshje për njohjen e dokumenteve zyrtare të lëshuara nga institucionet përkatëse në rajon, për të lehtësuar procedimin e kërkesave të personave të zhvendosur për ndihmë në kthim, integrim në vendin e zhvendosjes, regjistrim civil, ndihmë sociale, etj.
- Institucionet përkatëse duhet të bashkëpunojnë në përmirësimin e informatave të ofruara për personat e zhvendosur, të kthyerit potencialë dhe komunitetet pritëse dhe të vendosin kontaktimin me ta, duke u bazuar në shembujt pozitivë, siç është ai i ekipeve mobile të përbashkëta nga Kosova dhe Mali i Zi të themeluar për regjistrimin civil në Mal të Zi më 2014.
- Institucionet përkatëse duhet t'i zgjerojnë angazhimet formale të bashkëpunimit përtej MM-ve ekzistuese të ndërlidhura me projekte, dhe të lidhin marrëveshje që mbulojnë një gamë të gjerë të bashkëpunimit, duke përfshirë edhe fushat e cekura më lartë, veçanërisht në komunikim të rregullt, informim dhe shkëmbim të të dhënave, njohje të dokumenteve dhe vënie të kontakteve me personat e zhvendosur.

Për institucionet e nivelit qendror në Kosovë:

- Duhet të shtohet bashkëpunimi institucional, në nivel qendror dhe ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal, për të siguruar përparim në përmbushjen e zotimeve të Kosovës për kthim, duke përfshirë edhe themelimin e mekanizmave zyrtarë të koordinimit, siç edhe përcaktohet me Strategjinë e MKK-së. Udhëheqësia e fortë politike është e domosdoshme për të siguruar që këto zotime realizohen dhe orientohen drejt përparimit praktik.
- AKP-ja dhe institucionet e zbatimit të ligjit duhet ta përforcojnë bashkëpunimin për t'i trajtuar shpejt dhe efektshëm rastet e riuzurpimit të paligjshëm të pronave. Më saktë, AKP-ja duhet menjëherë të ngrisë kallëzim në PK dhe në Prokurori, ashtu që të sigurohet dëbimi i shpejtë i uzurpatorëve.
- Ministria e Kosovës për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor duhet ta ndryshojë Ligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme për t'i trajtuar mangësitë në procesin e njoftimit, veçanërisht në raport me pronarët e zhvendosur të pronave, dhe duhet ta miratojë Strategjinë për rregullimin e vendbanimeve joformale.

- Ministria e Kosovës për Financa duhet ta ndryshojë Ligjin për tatimin mbi pronën e paluajtshme për ta trajtuar çështjen e përgjegjësisë së personave të zhvendosur për pagesën e tatimit e akumuluar pronësor për pronat e tyre të uzurpuara.
- Policia e Kosovës duhet të ofrojë siguri për të gjitha komunitetet dhe të reagojë shpejte dhe efektshëm ndaj incidenteve që prekin komunitetet numerike në pakicë në nivelin lokal, duke e njohur ndjeshmërinë e veçantë të rasteve që kanë të bëjnë me të kthyerit, duke përfshirë edhe ndërlidhjen me komunitete për t'i dhënë siguri shtesë komuniteteve të prekura dhe për t'i ndarë informatat e duhura mbi trajtimin e mëtutjeshëm të rasteve.
- Agjencia Kosovare e Privatizimit duhet t'i lehtësojë procedurat për këmbim të tokës me komunitat në bazë të ligjit, sidomos në rastet kur toka nevojitet për projektet që kanë të bëjnë me kthimin.

Për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK):

- MKK duhet të ndërmarrë hapa për ta forcuar kornizën ligjore për kthim në mënyrë që të ofrojë udhëzime të detajuara për obligimet e institucioneve të Kosovës. Përderisa nismat për zhvillimin e legjislacionit për personat e zhvendosur brenda vendit janë të mirëseardhura, legjislacioni primar duhet të sigurojë një kornizë të qartë ligjore dhe t'i përkufizojë përgjegjësitë në lidhje me personat e zhvendosur që aktualisht janë jashtë Kosovës, si dhe të krijojë procedura dhe mekanizma që mundësojnë ushtrimin e të drejtës së tyre për t'u kthyer.
- Duhet të realizohen zotimet e shtruar në Strategjinë e MKK-së për Komunitete dhe Kthim (2014-2018) dhe të fuqizohet plani përkatës i veprimit me hollësi shtesë lidhur me afatet kohore dhe buxhetin, si dhe të publikohen dhe shpërndahen raportet vjetore për përparimin e shënuar.
- MKK duhet të themelojë mekanizma formalë, të menaxhuar nga niveli qendror, për pranimin dhe procesimin e kërkesave për kthim (dhe për VSHSH dhe VSHI).
- MKK duhet ta përmirësojë informimin publik dhe kontaktimin me personat e zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës për t'u siguruar që personat e zhvendosur të kenë qasje në asistencën që është në dispozicion në mënyrë që të mund të marrin vendime të informuara, për shembull përmes fushatave informuese, ekipeve mobile, caktimit të personave kontaktues apo masave tjera të mira.
- MKK-ja duhet ta forcojë menaxhimin dhe mbledhjen e të dhënave, duke përfshirë edhe përqendrimin në profilizim dhe përdorim të të dhënave të ndara sipas gjinisë për të pasur një pasqyrim të qartë të nevojave të ndryshme dhe çështjeve të burrave, grave, djemve dhe vajzave të zhvendosur. MKK-ja duhet ta udhëheqë zhvillimin e sistemeve të integruara dhe atyre të nivelit qendror për të mbledhur, analizuar dhe përcjellë raportet e MKK-së, për të nxjerrë raporte periodike të kombinuara të progresit të shënuar në tërë Kosovën. MKK duhet të zhvillojë dhe menaxhojë një sistem të centralizuar të menaxhimit të rasteve, i cili ushqehet me informata nga niveli lokal. Gjithashtu, MKK-ja duhet të ndërmerr hapa për t'u siguruar që të dhënat e mbledhura të përdoren si informata për planifikim strategjik dhe politikëbërje.
- ZKK-ja duhet ta forcojë bashkërendimin e saj me ZKKK-të, duke përfshirë ofrimin e këshillave dhe udhëzimeve, si dhe mbikëqyrjen dhe ndërmarrjen e veprimeve relevante përcjellëse me komunitat ku është identifikuar mungesë e punës së ZKKK-ve.

Për komunitat e Kosovës:

- Udhëheqësia komunale duhet të ndërmarrë hapa për të siguruar që të gjithë mekanizmat e nivelit komunal që mbështesin personat e zhvendosur do të funksionojnë në mënyrë efektive, në veçanti që: ZKKK-të t'i përmbushin të gjitha obligimet e cekura në kornizën ligjore të Kosovës dhe udhëzimet për politikën, dhe të luajnë rol më proaktiv në mbështetjen e personave të zhvendosur dhe të kthyer; grupet punuese komunale për kthim dhe Task Forcat të funksionojnë si duhet dhe që takimet e tyre ta përfshijnë komunitetin relevant dhe përfaqësuesit e të kthyerve; dhe që strategjitë komunale dhe planet e veprimit për kthimin të hartohen, miratohen dhe të raportohet mbi to, duke përfshirë shkëmbimin e informatave me akterët relevantë lokalë.
- Komunitetet duhet t'i përdorin të gjitha mundësitë në dispozicion për ndarjen e tokës për projektet që kanë të bëjnë me kthimin, përfshirë shkëmbimin e tokës me AKP-në dhe rivendosjen e pronësisë mbi parcelat specifike të tokës të ndërmarrjeve shoqërore që administrohen nga AKP-ja.
- Komunitetet duhet t'i përfshijnë nevojat e personave të zhvendosur dhe të kthyer në vlerësimin për nevojat e banimit në komunë dhe duhet t'i shfrytëzojnë më mirë skemat e banimit për të ndihmuar në plotësimin e nevojave të këtyre grupeve përmes planifikimeve më të mira, fushatat informuese dhe alokimin e fondeve adekuate
- Komunitetet duhet të ndërmarrin hapa për t'i trajtuar me shpejtësi incidentet e sigurisë që i prekin komunitetet, përfshirë përmes dënimit publik të tyre dhe vizitave tek komunitetet e prekura si dhe përmes publikimit të deklaratave në mediat e transmetuara (duke u siguruar që ato mbërrijnë tek të dy komunitetet, si tek ato shumicë ashtu edhe tek ato pakicë në nivel komunal), dhe duke i trajtuar çështjet përmes forumeve relevante të sigurisë në komunitet.
- Komunitetet duhet të angazhohen në mënyrë më proaktive në trajtimin e shqetësimeve që kanë të bëjnë me procesin e kthimit apo rezistencës nga komuniteti pranues, dhe ta lehtësojnë dialogun dhe nismat për zgjidhjen e problemeve në ato raste. Nismat e tilla duhet t'i përfshijnë organet relevante komunale dhe akterët e komunitetit, duke përfshirë ZKKK-të, grupet punuese komunale dhe task forcat si dhe, aty ku shihet e nevojshme, kryetarët e komunave, zëvendëskryetarët e komunave për komunitete, zëvendëskryesuesit e kuvendeve komunale për komunitete, komitetet për komunitete, këshillat komunalë për siguri në bashkësi etj.

SHTOJCA I TABELA 1: TABELA E FUNKSIONEVE TË NDËRMARRA NGA ZKKK-TË, NGA KOMUNA

Periudha raportuese që është përdorur për të mbledhur të dhëna për këtë tabelë ka qenë shtator 2012 - qershor 2014.

Vini re që statistikat e përdorura për tabelën më poshtë për të kthyerit, personat e zhvendosur brenda vendit dhe individët e interesuar për t'u kthyer janë siguruar nga UNHCR-ja të ndara sipas komunave që nga qershori i vitit 2014.¹¹¹

Rajoni	Komuna	Nr. i të kthyerve nga gushti 2012 deri në gusht 2014	Nr. i personave të zhvendosur	Nr. i personave të interesuar për tu kthyer	ZKKK bën kontaktim të rregullt ¹¹² , bën vizita, vlerësim të nevojave dhe apo mbledh informata për të drejtat e të kthyerve	ZKKK/ komuna lehtësim i VSHSH apo VSHI	Zyrtarët komunalë që nuk janë nga ZKKK-ja që kanë marr pjesë në ndonjë aktivitet që ka të bëjë me kthimin në komunë (p.sh. kryetari i komunës, personeli i drejtorive, anëtarët e komitetit për komunitete, etj.)	ZKKK apo komuna ka realizuar aktivitete në mbështetje të procesit të kthimit	Aktivitetet që janë ndërmarrë nga organizatat tjera në mbështetje të procesit të kthimit ¹¹³
Gjilan	Ferizaj/Uroševac	0	101	448	Po	Po (Të udhëhequra nga ON)	Po	Komuna i ka shpërndarë artikuj ushqimorë dhe jo-ushqimor të kthyerve serbë në bashkëpunim me MKK-në dhe OJQ-të.	MKK
	Gjilan/Gnjilane	14	39	274	Po	Po (Të udhëhequra nga ON)	Po	Jo	DRC, Mercy Corps, Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland.
	Hani i Elezit/Đeneral Jankovič	0	0	0	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo

¹¹¹ ‘Numri i përafërt i personave të zhvendosur brenda vendit, në Kosovë’, UNHCR, qershor 2014.

¹¹² Për shembull vizita në familje çdo dy muaj apo më tepër se 10 herë gjatë periudhës raportuese .

¹¹³ Informatat e siguruar për aktivitetet e ndërmarrë nga organizatat tjera në mbështetje të procesit të kthimit nuk janë shteruese, dhe përfaqësojnë ato informata që kanë qenë në dispozicion në nivel të terrenit, për të siguruar nivel të krahasueshëm të aktiviteteve në komunë.

	Kaçanik/Kaçanik	2	0	13	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
	Kamenicë/Kamenica	50	15	75	Po	Po (Të udhëhequra nga ON)	Po	Komuna i ka shpërndarë artikuj ushqimorë dhe jo-ushqimor të kthyerve serbë në bashkëpunim me MKK-në dhe OJQ-të.	DRC, Mercy Corps, MCR, Kryqi i Kuq i Kosovës.
	Kllokot-Vrbovac/Kllokot-Vërbovc	17	130	74	Jo	Jo	Jo	Jo	Mercy Corps
	Novobërdë/Novo Brdo	85	60	135	Po	Po (Të udhëhequra nga ON)	Po	Komuna i ka shpërndarë artikuj ushqimorë dhe jo-ushqimor të kthyerve serbë në bashkëpunim me MKK-në dhe OJQ-të.	Byroja për Popullatë, Refugjatë dhe Migrim me Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland, Mercy Corps, MCR, BE/IOM RRK Faza III e projektit , Mercy Corps, DRC
	Parteš/Partesh	0	283	16	Po	Po (Të udhëhequra nga ON)	Po	Komuna ka ndarë parcela tokësore për personat e zhvendosur dhe ka kontribuar me 20% të bashkëfinancimit në programin e IOM-it për kthim .	EU/IOM (RRKIII), BE/UNHCR
	Ranilug/Ranillug	45	15	8	Po	Jo	Jo	Jo	DRC, Mercy Corps
	Štrpce/Shtërpçë	131	634	69	Jo	Jo	Jo	Jo	EU/IOM RRK Faza III, MCR
	Viti/Vitina	1	27	61	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
Mitrovicë /Mitrovica	Leposavić/Leposaviq	5	2120	62	Nuk ka informata	Nuk ka informata	Jo	MKK është angazhuar me UNHCR-në në aktivitete të vlerësimit të nevojave	BE/Mercy Corps
	Mitrovicë/Mitrovica Jug	322	7087	389	Jo	Po (Të udhëhequra nga ON)	Jo	Jo	UNHCR, DRC, BE/Mercy Corps
	Mitrovica/Mitrovicë Veri		1952	0	Jo	Po	Jo	Jo	UNHCR
	Skenderaj/Srbica	4	28	50	Jo	Po (Të udhëhequra nga ON)	Po	Jo	Jo
	Vushtrri/Vuçitrn	13	92	84	Jo	Po (Të udhëhequra nga ON)	Jo	Komuna ka bashkëpunuar në një nismë dialogu të udhëhequr nga OSBE-ja për	Jo

								kthimet e mundshme në Vernicë/Vernica.	
	Zubin Potok	0	1563	30	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
	Zvečan/Zvečan	0	1290	26	Jo	Jo	Jo	MKK është angazhuar me UNHCR-në në aktivitete të vlerësimit të nevojave.	Jo
	Glogovc/Glogovac	0	0	5	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
	Podujevë/Podujevo	0	0	73	Po	Jo	Jo	Jo	Jo
Pej	Deçan/Deçane	8	7	36	Jo	Po (Të udhëhequra nga ON)	Po	Jo	BE-CS II
	Gjakovë/Đakovica	38	104	1009	Jo	Jo	Jo	Jo	BE-CS II
	Istog/Istok	91	0	1229	Jo	Po (Të udhëhequra nga ON)	Po	Jo	BE-CS II
	Junik	0	0	0	Nuk ka informata	Nuk ka informata	Nuk ka informata	Nuk ka informata	Nuk ka informata
	Klinë/Klina	40	1	1231	Po	Po	Jo	Jo	Komesariati i Serbisë për Refugjatë , EU/IOM, MCR
	Pejë/Peć	0	127	941	Jo	Po	Jo	Jo	EU RRK Faza II
Prishtinë	Fushë Kosovë/Kosovo Polje	0	143	280	Jo	Po	Jo	Jo	Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland
	Gračanica/Gračanicë	146	1143	299	Po (gjatë vitit 2013)	Jo	Jo	Komuna ka bashkëpunuar në një dialog të udhëhequr nga OSBE-ja për kthim të mundshëm.	MCR
	Lipjan/Lipljan	55	78	172	Po	Po	Po	Jo	MCR/BE
	Obiliq/Obilić	10	76	292	Jo	Po	Po	Jo	Jo
	Shtime/Štimlje	16	0	49	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
	Prishtinë/Priština	0	37	258	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
Prizren	Dragash/Dragaš	29	0	484	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
	Malishevë/Mališevo	1	0	3	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
	Mamuša/Mamushë/Mamuša	0	0	0	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo

	Prizren	0	52	479	Po	Po	Jo	Komuna e ka iniciuar në projekt për kthim të qëndrueshëm dhe riintegrim.	EU/IOM RRK III, DRC
	Rahovec/Orahovac	0	66	180	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
	Suharekë/Suva Reka	0	0	350	Jo	Po	Jo	Kryetari i komunës e ka krijuar një task forcë për të diskutuar kthimin e mundshëm në Mushutishtë/Mušutište, ku janë përfshirë MKK, ZKKK, UNHCR, IOM, tre persona të zhvendosur dhe një përfaqësues i fshatit; deri më tani janë organizuar tri takime .	Jo
	Totali	1,123	17,270	9,184	10 ndërmarrin vizita të rregullta në terren dhe bëjnë vlerësime të rregullta	18 kanë ndërmarrë VShSh/VShI	10 komuna i kanë përfshirë zyrtarët që nuk janë nga ZKKK-ja në aktivite të kthimit	10 komuna kanë realizuar aktivite në mbështetje të kthimit	n/a

SHTOJCA II TABELA 2: MEKANIZMAT KOMUNALË TË KRIJUAR DHE FUNKSIONALË, SIPAS KOMUNAVE

Periudha raportuese e shfrytëzuar për mbledhjen e të dhënave për këtë tabelë ka qenë shtator 2012- qershor 2014.

Vini re që statistikat e përdorura për tabelën më poshtë të të kthyerve, personave të zhvendosur brenda vendit dhe individëve të interesuar për t'u kthyer janë siguruar nga UNHCR-ja të ndara sipas komunave që nga qershori i vitit 2014.¹¹⁴

Rajoni	Komuna	Nr. i të kthyerve në periudhën gusht 2012 - gusht 2014	Numri i personave të zhvendosur	Nr. i personave të interesuar për t'u kthyer	ZKKK themeluar /funksional	Grupi Punues komunal i themeluar / funksional	Strategjia komunale për kthim është miratuar	Task Forca është krijuar	Ndonjë organ tjetër komunal që punon për kthim (p.sh ZKK, KK, ZKK)
Gjilan	Ferizaj/Uroševac	0	101	448	Po/Po	Po i themeluar / Po funksional	Jo, strategjia është hartuar por nuk është miratuar ende	Po	Komiteti për Komunitete
	Gjilan/Gnjilane	14	39	274	Po/Po	Po/Po	Po (maj 2012)	Po	Jo
	Hani i Elezit/Đeneral Jankovič	0	0	0	Po/Po	Jo	Jo	Jo	Jo
	Kaçanik/Kaçanik	2	0	13	Po/Po	Jo	Jo	Jo	Jo
	Kamenicë/Kamenica	50	15	75	Po/Po	Po/Jo	Jo	Jo	Nënkryetari i komunës për komunitete
	Klokot-Vrbovac/Kllokot-Vërbovc	17	130	74	Po/Po	Po/Jo	Jo	Po	Jo
	Novobërdë/Novo Brdo	85	60	135	Po/Po	Po/Po	Jo, strategjia është hartuar por nuk është miratuar ende	Po	Komiteti për Komunitete
	Parteš/Partesh	0	283	16	Po/Po	Po/Po	Po (korrik 2012)	Po	Jo
	Ranilug/Ranillug	45	15	8	Po/Po	Po/Jo	Jo, strategjia është hartuar por nuk është miratuar ende	Po	Jo
	Štrpce/Shtërpçë	131	634	69	Po/Po	Po/Po	Jo	Po	Jo

¹¹⁴ ‘Numri i përafërt i personave të zhvendosur brenda vendit në Kosovë’, UNHCR, qershor 2014.

	Viti/Vitina	1	27	61	Po/Po	Po/Jo	Jo	Jo	Jo
Mitrovicë /Mitrovica	Leposavić/Leposaviq	5	2120	62	Jo/*zyra komunale për komunitete vepron por jo për çështje të kthimeve	Po/Jo	Jo	Jo	Jo
	Mitrovicë/Mitrovica Jug	322	7087	389	Po/Po	Po/Jo	Jo	Jo	Jo
	Mitrovica/Mitrovicë Veri		1952	0	Jo/Zyra administrative në Mitrovica/Mitrovicë të veriut i mbulon kompetenca të ndryshme .	Po/Po	Jo	Jo	Jo
	Skenderaj/Srbica	4	28	50	Po/Po	Po/Jo	Jo	Jo	Jo
	Vushtrri/Vučitrn	13	92	84	Po/Po	Po/Jo	Jo	Jo	Jo
	Zubin Potok	0	1563	30	Jo/*Zyra komunale për komunitete vepron por jo në çështjen e kthimit	Jo	Jo	Jo	Jo
	Zvečan/Zveçan	0	1290	26	Jo/*Zyra komunale për komunitete vepron por jo në çështjen e kthimit	Po/Jo	Jo	Jo	Jo
	Glogovac/Glogovac	0	0	5	Po/Po	Jo	Jo	Jo	Jo
	Podujevë/Podujevo	0	0	73	Po/Po	Po/Jo	Jo	Jo	Jo
Pejë	Deçan/Deçane	8	7	36	Po/Po	Po/Jo	Jo	Po	Jo
	Gjakovë/Đakovica	38	104	1009	Po/Po	Jo	Jo	Po	Jo
	Istog/Istok	91	0	1229	Po/Po	Po/Jo	Jo	Po	Nënkryetari i komunës për komunitete
	Junik	0	0	0	Jo/Dy zyrtarë janë caktuar për të kryer detyrat përkatëse.	Jo	Jo	Jo	Jo
	Klinë/Klina	40	1	1231	Po/Po	Po/ Jo	Jo	Po	Jo
	Pejë/Peć	0	127	941	Po/Po	Jo	Jo	Po	Zëvendëskryesuesi i kuvendit komunal për komunitete
Prishtinë	Fushë Kosovë/Kosovo Polje	0	143	280	Po/Po	Po/Po	Jo	Po	Jo
	Gračanica/Graçanicë	146	1143	299	Po/Po	Po/ Jo	Jo	Po	Nënkryetari i komunës për komunitete
	Lipjan/Lipljan	55	78	172	Po/Po	Po/Po	Po (maj 2014)	Po	Nënkryetari i komunës për komunitete
	Obiliq/Obilić	10	76	292	Po/Po	Po/Po	Po (prill 2014)	Po	Jo
	Shtime/Štimlje	16	0	49	Po/Po	Po/Po	Jo	Po	Jo
	Prishtinë/Priština	0	37	258	Po/Po	Po/Po	Jo	Po	Jo

Prizren	Dragash/Dragaš	29	0	484	Po/Po	Po/Jo	Jo	Po	Jo
	Malishevë/Mališevo	1	0	3	Po/Po	Jo	Jo	Jo	Jo
	Mamuša/Mamushë/Mamuša	0	0	0	Po/Po	Jo	Jo	Jo	Jo
	Prizren	0	52	479	Po/Po	Po/Po	Po (maj 2013)	Po	Jo
	Rahovec/Orahovac	0	66	180	Po/Po	Po/Jo	Jo	Po (nuk është funksionale)	Jo
	Suharekë/Suva Reka	0	0	350	Po/Po	Po/Jo	Jo	Po (nuk është funksionale)	Jo
	Totalet	1,123	17,270	9,184	33 janë krijuar dhe janë funksionale 5 nuk janë krijuar, me funksionalitet deri në një masë	12 janë krijuar dhe janë funksionale 17 janë themeluar por nuk funksionojnë 9 nuk janë krijuar	5 janë miratuar	22 (2 nuk janë funksionale)	7 raste



SHTËPI BOSHE, TË NDËRTUARA PËR TË KTHYERIT SERBË TË KOSOVËS NË FSHATIN ZOOISHTË, KOMUNA E RAHOVECIT,
24 TETOR 2014 – OSBE/MARIYA STOYANOVA